




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION



RAPORTI VJETOR 2022

Prishtinë, mars 2023

PERMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
2. KORNIZA LIGJORE.....	8
2.1 Baza ekzistuese ligjore që rregullon Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik	8
2.2.Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese	8
2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet	8
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	9
3.1 Misioni/Vizioni	9
3.2.Kompetencat e KRPP- së.....	9
4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI.....	11
4.1 Parimet themelore të funksionimit	11
4.2 Struktura Organizative e KRPP-së	12
4.3 Bordi i KRPP-së	13
4.4 Departamentet dhe divizionet e KRPP-së.....	17
5. AKTIVITETET E KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK.....	23
5.1 Aktivitetet e Departamentit të Rregullave	23
5.2 Aktivitetet e Departamentit të Monitorimit.....	26
5.3 Aktivitetet e Departamentit të Trajnimeve.....	34
5.4 Aktivitetet e Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik	40
5.5 Aktivitetet e bashkëpunimit dhe përkrahjes nga donatorët.....	45
6. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KRPP-së	47

7. RAPORTI VJETOR FINANCIAR	50
8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TE REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	75
9. KONTRATAT E NËNSHKRUARA – STATISTIKAT	76
Numri i kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022	77
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022	78
Numri total dhe vlera financiare e kontratave vjetore mbi pragjet financiare të BE-së gjatë vitit 2022..	80
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022 sipas llojit të prokurimit	81
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022 sipas procedurave të prokurimit	85
Kontratat e nënshkruara dhe aneks-kontratat gjatë vitit 2022	89
Vlera e kontratave të nënshkruara sipas operatorëve ekonomik vendorë dhe jo-vendorë.....	90
Vlera e kontratave të nënshkruara sipas afatit kohor për publikim gjatë vitit 2022	91
Vlera e kontratave të nënshkruara sipas kriterit për dhënie kontrate gjatë vitit 2022	91
Numri mesatar i ofertuesve që kanë konkuruar për një tender gjatë vitit 2022	92
Vlera e kontratave të nënshkruara gjatë viteve 2017-2022	93
Numri dhe vlera e kontratave të nënshkruara në Kosovë nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2022..	94
Kontratat e nënshkruara me vlerë mbi 2,000,000.00€ nga autoritetet kontraktuese gjatë vitit 2022	98
SHTOJCA I - REALIZIMI I PLANIT TË PËRFORMANCËS 2022	100

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (në vijim “KRPP”) në përputhje me Nenin 87.2.13 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (tash e tutje “LPP”), për çdo vit kalendarik përgatitë dhe dorëzon në Qeveri dhe Kuvend raportin vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e legjislacionit në fushën e prokurimit publik.

Bazuar në LPP dhe Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, KRPP ka përgaditur këtë raport vjetor për periudhën kohore 01 janar – 31 dhjetor 2022, i cili përmbanë të dhëna dhe informacione mbi:

- Kornizën ligjore që rregullon funksionimin e institucionit
- Organizimin institucional të KRPP-së
- Fushëveprimin që e mbulon institucioni
- Aktivitetet e KRPP-së për periudhën raportuese
- Rekomandimet/sfidat e institucionit
- Raportimin financiar
- Raportimi rreth adresimit të rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, dhe
- Raportin statistikor të aktivitetëve të prokurimit publik dhe kontratave publike të nënshkruara në sektorin e prokurimit publik për vitin 2022.

Pjesë përbërëse e këtij raporti është gjithashtu edhe Raporti i Performancës i cili do përmbajë të dhëna mbi përmbushjen e Planit të Performancës për vitin 2022, plan i cili përmbanë objektivat dhe aktivitetet kryesore të cilat KRPP ka synuar t’i realizoj gjatë vitit 2022.

Raporti, krahas përshkrimit të institucionit në aspektin e mandatit ligjorë, organizimit institucional dhe fushëveprimit, si pjesë kryesore do të përmbajë aktivitetet dhe veprimet e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik gjatë periudhës raportuese, të cilat aktivitete dhe veprime kanë si qëllim kryesor garantimin e mirë funksionimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, duke u fokusuar sidomos në:

- Avancimin dhe përditësimin e kuadrit ligjorë të prokurimit publik
- Monitorimin e vazhdueshëm të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktuese
- Zhvillimin dhe avancimin e vazhdueshëm të prokurimit elektronik
- Ngritjen e kapaciteteve në prokurim publik nëpërmjet trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm,
- Dhënia e asistencës së vazhdueshme për Autoritetet Kontraktore me qëllim të rritjes së efikasitetit në prokurimit publik
- Rritjen e nivelit të transparencës në komunikim me publikun, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shoqërinë civile.

Progresi dhe rezultatet e arritura nga aktivitetet dhe veprimet e KRPP-së gjatë vitit 2022 do të paraqiten në kapitujt përkatës të këtij raporti, derisa shkurtimisht dhe me përgjegjësi të plotë mund të konstatohet që progresi dhe rezultatet e arritura janë pozitive dhe në pajtueshmëri me planin e planifikuar të performancës dhe mandatin ligjorë.

Nga të arriturat kryesore të KRPP-së si institucion dhe në prokurimin publik për periudhën raportuese, janë:

- Përgaditja dhe nxjerrja e **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik** e cila ka hyrë në fuqi me **01.11.2022**, dhe e cila adreson shumicën e dobësive të identifikuara gjatë zbatimit praktik të legjislacionit aktual në prokurimin publik.
- Sigurimi i pandërprerë i ofrimit të shërbimeve nëpërmjet **Sistemit të Prokurimit Elektronik**, nëpërmjet të cilit rreth **200** Autoritete Kontraktuese kanë zhvilluar **11,140** aktivitete të prokurimit dhe kanë nënshkruar **9,042** kontrata në vlerë prej **559,017,913.90 €**.
- Monitorimi i rreth 11,000 njoftimeve dhe dokumenteve përkatëse nga procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Autoritetet Kontraktuese, nëpërmjet të cilit monitorim është intervenuar në zbatim jo të drejtë të parimeve bazë të prokurimit publik, dhe janë evidentuar gjetjet dhe dobësitë për t'u adresuar dhe përmirësuar nga aspekti rregullativ i prokurimit publik.
- Trajnim dhe ngritje të kapaciteteve për rreth 379 zyrtarë nga Autoritetet Kontraktuese, prej të cilëve 43 zyrtarë janë pajisur me certifikatë themelore profesionale në prokurim, derisa rreth 61 zyrtarë janë trajnuar në përdorim të kriterit të dhënies “ **Tenderi me çmimin ekonomikisht më të favorshëm**”, dhe 250 menaxhim të kontratave nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik dhe aspekte tjera ligjore në prokurimin publik.
- Rritja e vlerës totale të kontratave të nënshkruara duke përdorur kriterin e dhënies “ **Tenderi me çmimin ekonomikisht më të favorshëm**” në krahasim me kriterin e dhënies “Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë”. Gjatë vitit 2022 vlera totale e kontratave me përdorim të kriterit të dhënies “ **Tenderi me çmimin ekonomikisht më të favorshëm**” ka arritur në **31,629,659.89 €**, ose rreth **5.66%** të totalit të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022, derisa në vitet paraprake 2020 -2021 nuk ka arritur **1%** të totalit të kontratave të nënshkruara.
- Rritja e numrit të kontratave të cilat administrohen dhe menaxhohen nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, duke shënuar një rritje prej **10%** ose **60 %** të të gjitha kontratave në sistem derisa në vitin 2021 ka qenë në rreth **50%**.

- Dhënia e këshillave, interpretimeve dhe rekomandimeve në aspektin ligjorë dhe teknik për të gjitha Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik gjatë të gjitha fazave të procedurave të prokurimit, prej të cilave duhet veçuar procedurat e prokurimit me përdorim të kriterit të dhënies “MEAT”, siç është procedura e prokurimit e zhvilluar nga Telekom i Kosovës e cila ka përfunduar me sukses nënshkrimin e kontratës për projektin “Migrimi në Kodin Telefonik të RKS dhe Modernizimi i Rrjetit Mobil” që është projekt me rëndësi vitale për Telekomin dhe interes strategjik për vendin.
- Në pajtueshmëri me ndryshimet e Rregullores së re të Prokurimit Publik, krahas ndarjes dhe qartësimit të “Rregullave të prokurimit” nga udhëzuesi për prokurim publik që aplikohen nga të gjitha AK-se dhe OE, janë vendosur norma ligjore të veçanta siç janë:
 - aplikimi i tavanit buxhetorë në implementim të kontratave kornizë me çmime njësi, që për pasojë ka patur realizimin apo shpenzimin e mjeteve buxhetore shumëfish më shumë se sa buxheti i planifikuar;
 - vendosja e afateve kohore (30 ditë) për nënshkrim të kontratave pas vendimit mbi dhënien e kontratës dhe përfundimit të fazave të ankimimit;
 - rishikim/plotesim i paragrafit rreth referencës së ndryshimit të çmimeve gjatë implementimit të kontratave i cili lejon aplikimin jo vetëm për kontrata afatgjata por për të gjitha kontratat në implementim – me kusht që i njejti paragraf është specifikuar në DT gjatë fazës së tenderimit;
 - Sqarimi i afateve kohore rreth parashtrimit të kërkesave për rishqyrtim/ankesave në OSHP për të gjitha llojet e vendimeve/dokumenteve tenderike;
 - Aplikimi i “çmimit jo normalisht të ulët” edhe për pozicione apo grup të pozicioneve – në rastin e kontratave me çmime njësi;
 - Definimi i kushteve të nenkontraktimit gjatë fazave të tenderimit dhe implementimit të kontratës, etj.
- Aplikimi i kufizimeve apo ndalimeve për përshkrime të Specifikimeve Teknike të investimeve në fushën e TIK të cilat: a) specifikojnë paisje, shërbime dhe prodhues të dyshimtë të teknologjisë së informacionit dhe telekomunikimit; b) paraqesin rrezik për sigurinë kibernetike dhe infrastrukturën kritike të vendit; dhe c) paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare të vendit
- Implementim i suksesshëm i ndryshimeve në sistem të prokurimit elektronik që për qëllim kanë patur përmirësimin e funksioneve të sistemit të prokurimit elektronik në ri-strukturimi të dokumenteve në aktivitetet e prokurimit nga ana e AK-se dhe OE, përfshirë thjeshtësimin e përgaditjes dhe dorëzimit të ofertave nga ana e OE. Ky avancim është vënë në përdorim nga data 01.11.2023 me hyrjen në fuqi të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim.

- Implementim i suksesshem i projektit të përbashkët me OSHP dhe të mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar (UK), projekt në avancim dhe modernizim të sistemit të ankimimit nga ana e OE dhe AK dhe shqyrtimit/menagjimit të ankesave nga ana e OSHP-së, dhe që për rezultat do ketë të dhëna të detajuara dhe në format të lexueshëm, dhe rritje të transparencës për ankesat e dorëzuara dhe shqyrtuara.
- Rritje të aktiviteteve që kanë të bëjnë me bashkëpunimin dhe koordinimin institucional, bashkëpunim me publikun, OJQ-të dhe partnerët ndërkombëtarë, nga të cilat aktivitete duhet veçuar: Aktivitetet e takimeve për diskutim mbi bashkëpunimin dhe koordinimin e Institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e Prokurimit Publik me partnerët USAID, Ambasadën Britanike dhe institucionet vendore OSHP, AQP, ZKA, Prokuroria e Shtetit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Inspektorati Policor dhe Autoriteti i Konkurrencës.
- Bashkëpunimin dhe nenshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (06.10.2022) me Zyrën Kombëtare të Auditimit për rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në fushën e zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik.
- Bashkëpunimin dhe nenshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (29.09.2022) me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës që për synim kryesor ka vendosjen dhe definimin e roleve, përgjegjësi dhe procedurave për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional të dy institucioneve si palë të interesit në prokurimin publik, për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm dhe të duhur të kornizës Rregullative të Prokurimit Publik dhe të Mbrojtjes së Konkurrencës.
- Vlerësimi i progresit në fushën e prokurimit publik dhe fushëveprimin që mbulon KRPP, vlerësim i paraqitur në raportet “ *Indeksi i Politikave të NVM-ve*” për vendet e ballkanit perendimorë, përfshirë Turqinë, dhe në “*Raportin e KE për vitin 2022*”.
- Vazhdimi në publikim të të dhënave të prokurimit sipas standardit të të dhënave të hapura me qëllim të rritjes së transparencës dhe përdorimit të të dhënave të prokurimit nga të gjitha palët e interesuara.
- Implementimi dhe aplikimi i veglës për monitorim të aktiviteteve të prokurimit nga ana e zyrtarëve të monitorimit të KRPP-së, monitorim i bazuar në indikatorë të përzgjedhur për aktivitete të prokurimit.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1 Baza ekzistuese ligjore që rregullon Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik

Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP) është themeluar në bazë të Pjesës VI të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Sipas nenit 86 të këtij ligji, KRPP-ja është agjenci e pavarur rregullative dhe sipas nenit 87 të këtij ligji është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që i jepen nga ky ligj.

Përveç ligjit bazë Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik me të cilin është themeluar dhe janë rregulluar funksionet e institucionit, KRPP ka të nxjerrur the publikuar edhe dy rregullore që rregullojnë organizimin e brendshëm dhe punën e KRPP-së:

- *Rregullore Nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik; dhe*
- *Rregullore e Punës e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik*

Gjithashtu, me qëllim të zbatimit të LPP, KRPP ka mandat që të vendosë rregulla të hollësishme të prokurimit të cilat janë pjesë përbërëse e legjislacionit dytësor për prokurim publik.

Nga rregulloret më të rëndësishme të legjislacionit dytësorë, KRPP ka të nxjerrur:

- *Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik*

, e cila ka për qëllim të plotësojë dhe sqarojë dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe gjithashtu përfshinë Rregullat për trajnime dhe revokim të certifikatave në prokurim publik.

2.2.Përmirësimi i bazës ligjore në periudhën raportuese

Në periudhën raportuese KRPP ka inicuar ndryshimin e Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOP) e cila është shfuqizuar me 01.11.2022 datë në të cilën ka hyrë në fuqi edhe Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Nxjerrja e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik është bërë me qëllim të ndarjes së rregullave të prokurimit nga udhëzuesi operativ për prokurim publik, dhe me qëllim të përditësimit dhe përshtatjes së legjislacionit dytësor me avancimet dhe ndryshimet në sistem të prokurimit elektronik.

2.3 Vështirësitë ligjore që ka hasur institucioni në përmbushjen e misionit të vet

Që nga vënia në përdorim të sistemit të prokurimit elektronik, KRPP në vazhdimësi është ballafaquar me mungesë të përshtatjes së legjislacionit parësorë me prokurimet elektronike apo ligjit aktual për prokurim publik. Një mungesë e tillë është synuar të plotësohet me draftimin dhe nxjerrjen e ligjit të ri për prokurimin publik, por i cili edhe gjatë periudhës së raportimit ende qëndron në fazën finale të draftimit. Në vazhdimësi mungesat dhe vështirësitë ligjore në këtë aspekt, KRPP i ka mbuluar nëpërmjet legjislacionit dytësor.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1 Misioni/Vizioni

Misioni i KRPP-së është zhvillimi funksionimi dhe mbikqyrja e përgjithshme e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e sistemit elektronik të prokurimit publik në Kosovë (E-Prokurimi).

Si rrjedhojë, misioni i KRPP-së është të nxis respektimin e parimeve themelore të prokurimit lidhur me transparencën, llogaridhënien, konkurrencën e ndershme, trajtim të barabartë dhe vlerën për para duke përmirësuar kapacitetin e sistemit të prokurimit përmes:

- Avancimit të sistemit të monitorimit për zbatimin të kornizës ligjore të prokurimit publik
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, trajnimi dhe arsimi;
- Avancimi i procedurave të menaxhimit të prokurimit publik;
- Rrjedhë më të mirë të komunikimit në mes të të gjithë akterëve të prokurimit publik;
- Prezantimin e objektivave socio-ekonomike dhe mjedisore, në kuadër të politikave të gjelbërta dhe të përgjegjshme shoqërore të prokurimit publik;
- Shfrytëzimit të metodave të reja bashkëkohore në zbatimin e ligjit të prokurimit publik si: prokurimit elektronik dhe prokurimi i centralizuar; si dhe
- Ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për funksionimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

3.2.Kompetencat e KRPP-së

KRPP-së bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik, neni 87, ka kompetencat si në vijim:

- të përditësoj legjislacionin dytësorë duke vendosur rregulla të hollësishme dhe në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-se për prokurim për të siguruar zbatimin adekuat të Ligjit për Prokurimin Publik nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilën nga procedurat e përcaktuara në LPP
- të ofroj opinione për autoritete kontraktuese në lidhje me vendimet e tyre, veprat apo anashkalimet gjatë aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave
- të kryej monitorimet e aktiviteteve të prokurimit dhe menaxhimit të kontratave për qëllim të monitorimit të zbatimit të LPP
- të përgatisë dhe shpërndajë doracakë të prokurimit, udhëzues, formularë dhe modele standarde për dokumentet e tenderit dhe të kontratave sipas LPP në dobi të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;
- të përforcojë vetëdijen në mesin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik për legjislacionin e prokurimit publik si dhe objektivat, procedurat dhe metodat e tij
- t'u japë ndihmë teknike dhe këshilla autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik

- për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të këtij ligji si dhe për të çdo dokument që nxirret nga KRPP;
- të nxjerrë dhe publikojë interpretime me shkrim të vendimeve administrative për të dyjat, autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik për zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të LPP dhe çdo dokumenti të nxjerrë nga KRPP-ja;
 - të krijojë dhe të mirëmbajë një Regjistër elektronik të Prokurimit Publik që shërben si vend për ruajtjen e kopjeve elektronike të të gjitha njoftimeve, ftesave, deklaratave, dosjeve të tenderit, raporteve, ankesave dhe vendimeve të arkivuara ose të nxjerra në lidhje me çdo aktivitet prokurimi të kryer ose të iniciuar nga një autoritet kontraktues;
 - të krijojë sisteme manuale dhe elektronike për monitorimin e zbatimit të këtij ligji nga ana e autoriteteve kontraktuese, duke përfshirë përgatitjen e formularëve të raportimit që duhet të plotësohen nga të gjitha autoritetet kontraktuese subjekte të këtij ligji;
 - të grumbullojë, analizojë dhe publikojë informacionet për procedurat e prokurimit publik dhe kontratat publike të dhëna;
 - për çdo vit kalendarik të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e LPP, raport ky që dorëzohet jo më vonë se në fund të marsit të vitit vijues kalendarik;
 - të krijojë dhe mirëmbajë një ëebfaqe informative në internet që i ofron publikut qasje të pa kufizuar në (i) këtë ligj dhe gjithë legjislacionin sekondar të nxjerrë sipas këtij ligji, (ii) interpretimet dhe dokumentet e përcaktuara në këtë nen dhe (iii) të gjitha informacionet që përmbahen në Regjistrin e Prokurimit Publik;
 - të zhvillojë një ëebfaqe dhe një sistem elektronik informativ në mbarë Kosovën për të përmirësuar publikimin e njoftimeve të kërkuara nga ky ligj;
 - të mbështesë zhvillimin e prokurimit elektronik, ankandit elektronik dhe komunikimit brenda fushës së prokurimit publik;
 - të përgatisë dhe mbajë një listë të autoriteteve kontraktuese që i identifikon të gjitha entitetet që janë subjekt i këtij ligji, me kusht që nëse KRPP-ja nuk e përfshin një entitet në këtë listë, kjo (mos-përfshirja) të mos vendosë çështjes se nëse entiteti është jo autoritet kontraktues në kuptim të këtij ligji; dhe
 - të ndër veprojë dhe të bashkëpunojë me organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit për çështjet që lidhen me prokurimin publik.
 - të zhvilloj dhe implementoj rregullat e detajuara në lidhje me shitjen e aseteve të Autoriteteve Kontraktuese.

4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON INSTITUCIONI

Fushëveprimi i KRPP-së përcaktohet me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, ku si fushëveprim kryesorë ka përgjegjësitë e rregullatorit në sektorin e prokurimit publik në Kosovë (përgaditja e legjislacionit dytësorë, interpretimeve dhe opinioneve në prokurim publik, monitorimi i zbatimit të legjislacionit në prokurim publik, trajnimeve, etj), dhe me aplikimin e prokurimit elektronik i është shtuar edhe përgjegjësia e ofruesit të shërbimeve gjithashtu.

4.1 Parimet themelore te funksionimit

Komisioni Rregullativ per Prokurimit Publik, edhe për sa i përket mënyrës së organizimit dhe funksionimit, mbështetet në Nenit 142 (Kapitulli XII) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Pjesës VI të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Ligjin e administratës shtetërore L-06-113, Rregulloren nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura.

Bordi i KRPP-se mbështetur në nenin 90 te LPP-se dhe në bazë të nenit 7 të Rregullores së punës së KRPPsë, në takimin e mbajtur më 22.12.2020 ka miratuar Rregullore Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik.

Aktualisht, këto rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit, janë detajuar në Rregulloren nr 01/2020. Kjo rregullore përfshinë kornizimin në mënyrë më të plotë, të organizimit të funksionimit të KRPP-se, duke përfshirë kompetencat e Bordit te KRPP-se dhe administratën e institucionit.

Komisioni Rregullativ per Prokurim Publik me veprimtarinë e saj në cilësinë e një agjencie të pavarur rregullatorë përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në ngritjen e vetëdijes në mesin e AK dhe OE për zbatimin e drejte të kornizën ligjore për prokurimit publik në zhvillimin sa me të drejte dhe efikas të procedurave të prokurimit nga AK, duke synuar parandalimin e cdo veprimi kundërligjor që cenon interesin publik në radhe të pare, interesin e palëve të interesit, cenon parimin e transparencës, barazisë, si dhe konkurrencës, e për më tepër përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efience të fondeve publike.


4.2 Struktura organizative e KRPP-së

Struktura organizative e KRPP-së është e rregulluar sipas *Rregullores Nr. 01/2020 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik*, dhe ka përbërjen si në vijim:

- Bordi i KRPP-së
- Departamenti i Rregullave
- Departamenti i Monitorimit
- Departamenti për Trajnime dhe Integritet
- Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik
- Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta (DSHP)
- Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Zyrtari Përgjegjës për Prokurim
- Zyrtari Përgjegjës për Financa

Struktura organizative e KRPP-së me përbërjen e listuar më lartë, paraqitet edhe me **organogramin** si në vijim:

Organogrami i KRPP-së



Institucioni i KRPP-së është i vendosur në hapësirat dhe zyret e bodrumit/perdhesës në Ndertesën e ish-Germise, Zona B, të cilat vlerësohet se janë hapësira jo standarde për punë dhe konsiderohen si ambient me rrezikshmëri të lartë për shëndetin e njeriut, gjithmone duke patur parasyshë që:

- Shumica e hapësirave janë pa dritare të mjaftueshme (ose fare pa dritare), me pamjaftueshmeri të oksigjenit dhe ndriqimit natyral, me lagështi dhe kundërmim nga ambienti i papastër.

Në lidhje me këtë KRPP disa herë i është drejtuar ministrisë përkatëse (MPB) për të siguruar lokacion të ri për KRPP-në, por deri më tani ende nuk është bërë ndonjë zgjidhje.

4.3 Bordi i KRPP-së

Sipas nenit 89 të Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Bordi i KRPP-së përbëhet prej tre (3) anëtarëve. Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat prej 5 (pesë) vjeçar pa të drejtë riemërimi.

Kryetari i KRPP-se është emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me vendimin e datës 02.11.2018 për një mandat pesë (5) vjeçar, ndërsa dy anëtarëve të bordit të KRPP-se janë emëruar me vendimin e datës 19.04.2022 për një mandat pesë (5) vjeçar.

Puna dhe organizimi i bordit të KRPP-së është i rregulluar me Nenin 90 të LPP-së, derisa çështjet që janë trajtuar në vendimmarrjen e Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik gjatë vitit 2022 kanë pasur të bëjnë me:

- Formimi i komisioneve për trajtim të kërkesave për revokim të certifikatave
- Shqyrtimi i kërkesave për revokim të certifikatave për zyrtaret përgjegjës të prokurimit
- Shqiptimin e masave për zyrtaret përgjegjës të prokurimit
- Formimi i komisioneve për hartimin e akteve detyësore
- Aprovimi i akteve detyësore
- Veprimet procedurale të menaxhimit për zyrtaret e KRPP-se

Rreth punës së bordit të KRPP-së për periudhën raportuese, në tabelën më poshtë janë paraqitur të dhëna mbi mbledhjet dhe vendimet gjatë vitit 2022, përfshirë edhe përshkrimin e vendimeve.

Vendimet e KRPP –së për vitin 2022			
Nr	Nr. i Vendimit	Data	VENDIM
1	01/2022	11.01.2022	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë vlerësimin e pasurisë së KRPP-së
2	03/2022	14.01.2022	Për caktimin e 2 anëtarëve të Komisionit me mandat 3 vjeçar për shqyrtimin e kërkesave për revokim të certifikatës profesionale të prokurimit
3	04/2022	14.01.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Departamentit të Monitorimit, dërguar përmes emailit me 14.12.2021 për revokimin e certifikatës së prokurimit, zyrtarit përgjegjës të prokurimit të Autoritetit Kontraktues "Komuna e Suharekës"
4	06/2022	07.02.2022	Vendim për shpërblim për 2 zyrtarë të KRPP-së për kontributin e tyre 10 vjeçar në Shërbimin Civil të Kosovës
5	07/2022	16.02.2022	Vendim për caktimin si person përgjegjës anëtarin e Bordit të KRPP-së z. Ergin Kala për organizimin dhe udhëheqjen e punës në zhvillimin, ndryshimin e uebfaqes së KRPP-së, avancimin dhe zhvillimin e Divizionit të Analizave, udhëheqjen dhe organizimin e punëve në Departamentin e Trajnimeve

RAPORTI VJETOR 2022

6	08/2022	21.02.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Departamentit të Monitorimit, dërguar përmes emailit me 21.01.2022 për revokim të certifikatës së prokurimit, zyrtarit përgjegjës të prokurimit të Autoritetit Kontraktues "Posta e Kosovës SH.A"
7	09/2022	24.02.2022	Vendim për shpërblim për 1 zyrtar të KRPP-së për kontributin e tij 10 vjeçar në Shërbimin Civil të Kosovës
8	10/2022	28.02.2022	Vendim mbi refuzimin e kërkesës së Departamentit të Monitorimit në KRPP të datës 14.12.2022 parashtruar Bordit të KRPP-së për revokim të certifikatës profesionale të prokurimit për ish zyrtarin përgjegjës të Prokurimit Publik të Komunës së Suharekës.
9	11/2022	11.03.2022	Për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë/KVLB për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Shërbimeve të Përgjithshme
10	12/2022	11.03.2022	Për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë/KVLB për pozitën Udhëheqës i njësisë së shërbimit të menaxhimit financiar
11	13/2022	11.03.2022	Për formimin e komisionit disiplinor
12	14/2022	28.03.2022	Vendim mbi refuzimin e kërkesës së Departamentit të Monitorimit në KRPP të datës 21.01.2022 parashtruar Bordit të KRPP-së për revokim të certifikatës profesionale të prokurimit për zyrtarin përgjegjës të Prokurimit Publik të Autoritetit Kontraktues Posta e Kosovës.
13	15/2022	31.03.2022	Z. Musli Iballi nga Zyrtar për Trajnime caktohet në punët dhe detyrat e Zëvendës Udhëheqësit të Divizionit për Trajnime me koeficient të pagës nëntë, në kuadër të Departamentit të Trajnimeve dhe Integriteteve
14	16/2022	31.03.2022	Znj. Florie Salihi, nga Eksperte e Prokurimit caktohet në punët dhe detyrat e Zëvendës Udhëheqësit të Divizionit për Interpretime me koeficient të pagës 9, në kuadër të Departamentit të Rregullave
15	17/2022	31.03.2022	Z. Nazmi Gërvalla nga pozita Ekspert i TI-së për Prokurim caktohet në punët dhe detyrat e Zëvendës Udhëheqësit të Divizionit për Procese të Prokurimit Elektronik me koeficient të pagës 9 në kuadër të Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik
16	18/2022	31.03.2022	Z. Hafiz Guraziu nga Administrator i Qendrës së të Dhënave të Rrjetit dhe Sigurisë, caktohet në punët dhe detyrat e Zëvendës Udhëheqësit të Divizionit të TI për Aministim të Sistemit të Prokurimit Elektronik me koeficient të pagës 9 në kuadër të Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik
17	19/2022	04.04.2022	Për aprovimin e kërkesës për pushim pa pagesë të zyrtarit si Programues i Faqeve të Internetit
18	28/2022	05.05.2022	Znj. Albenita Berisha nga Zyrtare për Analiza, caktohet në punët dhe detyrat e Zëvendës Udhëheqësit të Zyrtarit Kryesor Financiar me koeficient të pagës 9
19	29/2022	05.05.2022	Për formimin e Ekipit përgjegjës për plotësim ndryshim të aktit nënligjor A01
20	30/2022	11.05.2022	Për lejimin e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë së znj. Fitore Bajra - Asistente e Lartë Ekzekutive pranë Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik
21	36/2022	02.06.2022	Vendim për pagesën e shtesës në pagë duke u mbështetur në nenin 9 të Udhëzimit Administrativ 08/2006 për nëpunësen e kabinetit, asistente e lartë ekzekutive.

RAPORTI VJETOR 2022

22	42/2022	12.07.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", dërguar përmes emailit dhe shpresës fizike me 05.07.2022 për revokimin e certifikatës së prokurimit zyrtarit përgjegjës të prokurimit të Autoritetit Kontraktues Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina "
23	43/2022	12.07.2022	Për aprovimin e kërkesës për pushim pa pagesë të z. Jetullah Kabashi - Ekspert i Prokurimit
24	44/2022	13.07.2022	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëj pranimin e pasurive jo financiare lidhur me aktivitetin e Prokurimit "Furnizim me laptop"
25	49/2022	09.08.2022	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëj pranimin e pasurive jo financiare lidhur me aktivitetin e Prokurimit "Furnizim me material zyrtar - letër"
26	51/2022	12.08.2022	Vendim për caktimin si person përgjegjës anëtarin e Bordit të KRPP-së z. Avni Sahiti për organizimin dhe udhëheqjen e punës së Divizionit të Monitorimit, me qëllim të avancimit dhe zhvillimit të këtij Divizioni i cili është në kuadër të Departamentit të Monitorimit
27	52/2022	12.08.2022	Vendim për caktimin si person përgjegjës anëtarin e Bordit të KRPP-së znj. Fidane Spahija Gjokolli si person përgjegjës për të organizuar dhe udhëhequr punën e Departamentit të Trajnimeve dhe punën e Divizionit të Analizave me qëllim të avancimit dhe zhvillimit të këtij divizioni i cili është në kuadër të Departamentit të Monitorimit
28	55/2022	26.08.2022	Vendim për pagesën e një page mesatare në vlerë prej 350 euro për nëpunësin Musli Iballi me rastin e vdekjes së babait duke u mbështetur në nenin 22 të Ligjit nr 03/ L 147 për Pagat e Nëpunësve Civil, neni 22 paragrafi 2 i Rregullores nr. 33/2012 për Shtesat në pagë dhe Komensimet tjera të Nëpunësve Civil
29	36/2022 (2x)	08.09.2022	Vendim mbi anulimin e certifikatës profesionale për zyrtarin përgjegjës të Prokurimit të Autoritetit Kontraktues Universiteti i Prishtinës
30	37/2022	08.09.2022	Plotesim/ndryshim i vendimit nr. 03/2022 të datës 14.01.2022 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për ndryshimin e kryesueses së Komisionit për Revokim të certifikatës profesionale të prokurimit.
31	38/2022	13.09.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit dërguar përmes emailit me 16.08.2022 për vërejtje ndaj Drejtorit të Zyrës së Prokurimit të Autoritetit Kontraktues Ministria e Rinisë, Sportit dhe Kulturës
32	39/2022	13.09.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit dërguar përmes arkivit me 25.08.2022 për revokim të certifikatës së prokurimit, zyrtarit përgjegjës të prokurimit të Autoritetit Kontraktues KK Kllokot.
33	40/2022	14.09.2022	Për aprovim të kërkesës për pushim pa pagesë të z. Jetullah Kabashi nga data 15.09.2022 - 31.12.2022.
34	41/2022	21.09.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit dërguar përmes emailit me 13.09.2022 për revokim të certifikatës së prokurimit ndaj Zyrtarit të Prokurimit të Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme
35	42/2022	14.10.2022	Për formimin e Komisionit për hartimin e Planit Vjetor të Performancës.
36	43/2022	20.10.2022	Për refuzimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit të datës 16.08.2022, të parashtruar në Bordin e KRPP-së për shqiptimin e një vërejtjeje për zyrtarin e prokurimit publik të Autoritetit Kontraktues të MKRS-së.

37	44/2022	21.10.2022	Për refuzimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit të datës 13.09.2022, të parashtruar në Bordin e KRPP-së për anulimin e certifikatës profesionale për zyrtarin përgjegjës të prokurimit publik të Autoritetit Kontraktues të MPB-së.
38	45/2022	25.10.2022	Për refuzimin e kërkesës së OSHP-së të datës 13.09.2022 e parashtruar në Bordin e KRPP-së, për anulimin e certifikatës profesionale për zyrtarin përgjegjës të prokurimit publik të autoritetit kontraktues KK- Kllokot.
39	46/2022	28.10.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Organit Shqyrtues të Prokurimit dërguar përmes emailit me 17.10.2022 për revokim të certifikatës së prokurimit për zyrtarin e prokurimit të Autoritetit Kontraktues të QKKTGJ-së.
40	48/2022	07.11.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së OSHP-së dërguar përmes emailit me 31.10.2022 për revokim të certifikatës së prokurimit, zyrtarit përgjegjës të prokurimit të Autoritetit Kontraktues Ministria e Shëndetësisë
41	49/2022	07.11.2022	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë regjistrimin e depos së KRPP-së
42	50/2022	07.11.2022	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiare të KRPP-së
43	51/2022	07.11.2022	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë tjetërsimin e pasurive jo financiare të KRPP-së
44	53/2022	16.11.2022	Për aprovimin e kërkesës për pushim pa pagesë të z. Ermal Shala - Administrator i Bazës së të Dhënave
45	55/2022	22.11.2022	Për caktimin e Komisionit i cili do të bëjë inventarizimin e pasurisë jo financiare të KRPP-së.
46	60/2022	02.12.2022	Për plotësim ndryshimin e vendimit nr. 59/2022 të datës 02.12.2022 të Komisionit Rregullativ për caktimin e Komisionit për vlerësimin e aplikacioneve për Trajnim Bazik
47	61/2022	05.12.2022	Për refuzimin e kërkesës së OSHP-së të datës 17.10.2022 të parashtruar në Bordin e KRPP-së për anulimin e certifikatës profesionale për Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit Publik të Autoritetit Kontraktues QKKTGJ,
48	62/2022	08.12.2022	Z. Ismail Rushiti, nga Ekspert i Prokurimit, caktohet në punët dhe detyrat e Zëvendës Udhëheqësit të Divizionit për Interpretime me koeficient të pagës 9, në kuadër të Departamentit të Rregullave
49	64/2022	13.12.2022	Për caktimin e Komisionit për trajtimin e kërkesës së Departamentit të Monitorimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skënderbeu - Suharekë" ritender.
50	65/2022	14.12.2022	Për caktimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave të aplikacioneve për Trajnim Bazik
51	67/2022	30.12.2022	Për refuzimin e kërkesës së OSHP-së të datës 31.10.2022 parashtruar në Bordin e KRPP-së për anulimin e certifikatës profesionale për zyrtarin përgjegjës të prokurimit publik të Autoriteti Kontraktues Ministria e Shëndetësisë. Të njëjtit i shqiptohet masa Vërejtje me shkrim.
52	68/2022	30.12.2022	Për aprovimin e kërkesës së Departamentit të Monitorimit të KRPP-së të datës 09.12.2022 parashtruar në Bordin e KRPP-së për trajtim të shkeljeve dhe të gjeturave gjatë monitormit për Zyrtarin përgjegjës të prokurimit publik të Autoritetit Kontraktues Komuna e Suharekës.

Tabela 1

4.4 Departamentet dhe divizionet e KRPP-së

Departamenti i Rregullave

Misioni i Departamentit të Rregullave është të vendosë rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin e LPP-së si dhe interpretime në fushën e prokurimit publik si dhe nxjerrjen e formularëve dhe përgatitjen e legjislacionit sekondar.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit të Rregullave janë:

- Harton planin e punës për departamentin
- Vendos rregulla të hollësishme për të siguruar zbatimin adekuat të LPP-së nga autoritetet kontraktuese si dhe rregulla për përdorimin dhe ekzekutimin e secilës nga procedurat e përcaktuara në nenet 33-37 të LPP-së me kusht që, këto rregulla të jenë në përputhje me kërkesat dhe parimet e përcaktuara nga LPP-ja si dhe çfarëdo kërkesë të detyrueshme të BE-së për prokurim
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë
- Koordinon punën në zhvillimin e dokumenteve strategjike lidhur me prokurimin publik të cilat hartohen nga strukturat e KRPP-së
- Mbikëqyr pranimin e kërkesave dhe dokumenteve të bashkëngjitura të parashtruara nga palët e interesuara vlerëson nëse nevojitet kompletim apo sqarim
- Bashkëpunon me departamentet tjera në kuadër të institucionit për funksionimin sa më të mirë të punëve që lidhen me politikën e prokurimit.

Drejtori i Departamentit të Rregullave raporton tek Kryetari i KRPP-së.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet në vijim:

- Divizioni për Legjislacion
- Divizioni për Interpretime.

Departamenti i Monitorimit

Misioni i Departamentit të Monitorimit është të vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të LPP-së dhe rregullave të nxjerra nga KRPP-ja sipas autorizimit të LPP-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Monitorim janë:

- Harton planin e punës për departamentin
- Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime për sistemin dhe legjislacionin për prokurim me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe përgjegjësisë në punë
- Përgatit dhe zbaton një metodologji dhe mekanizëm të përshtatshëm raportimi të mbështetur

nga sistemi elektronik i prokurimit dhe/ose një sistem tjetër të menaxhimit të informacionit që i mundëson të vëzhgojë zbatimin e këtij ligji

- Përgatit raporte mbi rezultatet dhe zbatimin që identifikojnë përparësitë dhe dobësitë në zbatimin e këtij ligji ose sistemi të prokurimit
- Identifikon ato fusha që kanë nevojë të përmirësohen dhe zhvillohen
- Përgatit raportet vjetore që kërkohen nga ky ligj në mënyrë që të japin një vlerësim të përgjithshëm por të saktë të gjendjes së sistemit kombëtar të prokurimit si dhe vlerësime të veçanta të shkallës së përputhjes/mospërputhjes nga autoritetet individuale kontraktuese
- Bën rekomandimet e duhura për ndryshimin e legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e prokurimit publik.

Udhëheqësi i Departamentit për Monitorim raporton tek Kryetarit i KRPP-së.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet në vijim:

- Divizioni për Monitorim dhe Mbikëqyrje
- Divizioni për Analizë dhe Statistika.

Departamenti për Trajnime dhe Integritet Evropiane

Misioni i Departamentit për Trajnime dhe Integritet Evropiane është të zhvillojë dhe organizojë trajnime për programin Themelor Profesional dhe për programin e Avancuar profesional për prokurim sipas nenit 25 të LPP-së si dhe për çështjet që lidhen me prokurimin publik sa i përket procesit të integritetit evropian dhe më gjerë, kompetencë kjo e KRPP-së sipas nenit 87 të LPP-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Trajnime dhe Integritet Evropiane janë:

- Harton planin e punës për departamentin
- Zhvillon module të trajnimit dhe kurikulës për kualifikimet në prokurim të zyrtarëve të Prokurimit për trajnime Themelore dhe të Avancuara (Nivelin Qendror dhe Lokal, OE, OJQ) duke përgatitur katalogun, programet, modulet për trajnime
- Identifikon personat me përvojë në prokurimin publik, të përshtatshëm për mësimdhënie në kurset e prokurimit të hartuara nga KRPP-ja për Trajnim Themelor dhe të Avancuar dhe për trajnime të tjera
- Harton një listë të dokumentuar të kualifikimeve për certifikim si trajnerë dhe si pjesëmarrës në trajnimet e prokurimit. Lista e kualifikimeve publikohet në ueb-faqen e KRPP-së.

Drejtori i Departamentit për Trajnime dhe Integritet raporton te Kryetari i KRPP-së.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet në vijim:

- Divizioni për Trajnim dhe
- Divizioni për Integritet.

Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik

Misioni i Departamentit për Sistem të Prokurimit Elektronik është të udhëheqë dhe administrojë të gjitha shërbimet e TI-së që janë në funksion të sistemit të prokurimit elektronik.

- Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të departamentit për sistem të prokurimit elektronik janë:
 - Siguron operimin dhe funksionim të pandërprerë të shërbimeve që ofrohen nga platforma e prokurimit elektronik
 - Udhëheq dhe menaxhon në baza ditore të gjithë stafin e TI-së përgjegjës për administrim dhe përkrahje të sistemit të prokurimit elektronik në KRPP
 - Analizon dhe vlerëson në baza ditore funksionimin, operimin dhe performancën e sistemit të prokurimit elektronik të implementuar në KRPP, përfshirë analizimin dhe aprovimin e propozimeve për avancim, modifikim, riparim dhe përditësim të moduleve dhe funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik
 - Planifikon dhe përgatit në mënyrë të detajuar planet 6 (gjashtë) mujore dhe vjetore mbi përditësimet, përmirësimet dhe avancimet e sistemit të prokurimit elektronik për pjesën harduerike dhe softuerike të sistemit
 - Përgatit dhe përditëson politikat e sigurisë dhe procedurat standarde të operimit të platformës së prokurimit elektronik për t'u zbatuar nga stafi i TI-së
 - Ofron këshillime për menaxhmentin e KRPP-së në lidhje me çfarëdo që ndërlidhet me sistem të prokurimit elektronik
 - Bashkëpunon me të gjitha palët e interesit dhe në lidhje me platformën e sistemit të prokurimit elektronik
 - Shërben si pikë koordinuese me të gjitha palët në nivel qeveritar (MAP, MF, etj.) të përfshira në funksionim dhe operim të sistemit të prokurimit elektronik.

Drejtori i Departamentit raporton tek Kryetari i KRPP-së.

Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë Divizionet si vijon:

- Divizioni i TI-së për Administrim të Sistemit të Prokurimit Elektronik, dhe
- Divizioni për Procese të Prokurimit Elektronik.

Zyrtari përgjegjës për Financa

Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit për Buxhet dhe Financa janë:

- Përgatit propozimet buxhetore në koordinim me strukturat organizative të ministrisë
- Koordinon çështjet buxhetore për të gjitha strukturat organizative të ministrisë
- Siguron që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore si dhe raporton mbi ekzekutimin buxhetor
- Monitoron rrjedhën e parasë, llogaritë, transaksionet dhe parametrat tjerë financiar që tregojnë performancën financiare të KRPP-së
- Menaxhon rezervat e parasë dhe siguron se kontrolli i brendshëm financiar është i bazuar në parimet e llogaridhënies
- Siguron bashkëpunim të ngushtë me auditorin e brendshëm dhe të jashtëm në përgatitjen e pasqyrave buxhetore dhe financiare të auditimit.

Zyrtari përgjegjës për Financa raporton tek Kryetari i KRPP-së.

Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta

Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Shërbimeve të Përbashkëta janë:

- Ofron ndihmë logjistike për takimet e personelit të KRPP-së
- Siguron mbështetje me shërbimet e teknologjisë së informacionit për ministrinë
- Menaxhon inventarin dhe depot e KRPP-së
- Koordinon kërkesat dhe nevojat e KRPP-së për mallra dhe pajisje të zyrës për punë
- Menaxhon nevojat e transportit dhe automjetet e KRPP-së
- Mirëmban dhe administron sistemin e arkivit të KRPP-së
- Menaxhon me zyrën pritëse të KRPP-së.

Udhëheqësi për shërbime të përbashkëta raporton tek Kryetari i KRPP-së.

Zyrtari përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Zyrtari për menaxhimin e burimeve njerëzore ka mision zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe procedurave lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë:

- Analizimi i nevojave të punësimit, zhvillimi i planit të personelit, koordinimi dhe siguri i procesit të rekrutimit si dhe përgatitja e përshkrimeve të punës
- Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për zhvillimin e kapaciteteve të personelit, siguri i trajnimeve adekuatë dhe vlerësimi i ndikimit të trajnimeve
- Menaxhimi dhe mbështetja e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të personelit
- Siguri i kompensimeve dhe përfitimeve të tjera për personelin sipas legjislacionit në fuqi
- Menaxhimi i veprimeve disiplinore dhe mosmarrëveshjeve midis punonjësve ose ndërmjet

punonjësve dhe menaxhmentit

- Sigurimi i realizimit dhe mbrojtja e të drejtave të punësuarave sipas legjislacionit në fuqi.

Zyrtari përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore raporton tek Kryetari i KRPP-së.

Zyrtari përgjegjës për Prokurim

Zyra e prokurimit ka si mision të sigurojë që të gjitha aktivitetet e prokurimit të institucionit të jenë në pajtim me dispozitat e legjislacionit dhe rregullave të prokurimit si dhe zhvillimin e strategjive dhe dokumenteve të prokurimit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit përgjegjës për Prokurim janë:

- Përgatit, koordinon dhe zbaton planin vjetor të KRPP-se në fushën e prokurimit publik, në pajtim me legjislacionin në fuqi
- Siguron që të gjitha kërkesat e prokurimit janë përgatitur dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e prokurimit
- Përcakton metodologjinë e prokurimit për tender dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve
- Ofron këshilla dhe asiston menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave
- Koordinon dhe bashkëpunon me Agjencinë e Prokurimit Publik (APP), Komisionin Rregullator të Prokurimit Publik (KRPP) dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) sa i përket procedurave të prokurimit publik.

Udhëheqësi i Prokurimit raporton tek Kryetari i KRPP-së

Burimet njerëzore

Numrit i pozitave të aprovuara, sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike - numri total i punonjësve, vijon të jetë i njëjtë me vitin paraprak, në një numër total prej 42 pozitave. Struktura themelore organizative e KRPP-së përbëhet nga Bordi, katër departamente, nëntë divizione dhe tri njësi.

Bazuar në aktet nënligjore të sipërcituara, struktura organizative e Komisionit Rregullativ për Prokurimit Publik me kategorizim të pozicioneve është si më poshtë:

Pozita	Kategoria	Nr. i zyrtarëve
Kryetar		1
Anëtar i Bordit		2
Asistente e lartë		1
Departamenti i Rregullave		
Drejtori i Departamentit	Drejtues i mesëm	1
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	2
Ekspert	Profesional	2
Zyrtar i lartë	Profesional	1
Zyrtar	Profesional	1
Departamenti i Monitorimit		
Drejtori i Departamentit	Drejtues i mesëm	1
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	2
Ekspert	Profesional	5
Zyrtar	Profesional	2
Departamenti për Trajnime dhe Integritet		
Drejtori i Departamentit	Drejtues i mesëm	1
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	2
Ekspert	Profesional	1
Zyrtar	Profesional	3
Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik		
Drejtori i Departamentit	Drejtues i mesëm	1
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	2
Ekspert	Profesional	3
Administrator i Bazës së të dhënave	Profesional	2
Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta		
Udhëheqës i Divizionit	Drejtues i ulet	1
Zyrtar	Profesional	2
Njësia për menaxhimin e burimeve njerëzore		
Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	Drejtues i ulet	1
Njësia për menaxhimin e financave		
Zyrtari Përgjegjës për Financa	Drejtues i ulet	1
Njësia për prokurim publik		
Zyrtari Përgjegjës për Prokurim	Drejtues i ulet	1

Tabela 2

Ne lidhje me këtë strukturë, fokusi i institucionit ka qenë në rritjen e kapaciteteve të stafit. Me qëllim të funksionalizimit të strukturës organizative, gjatë vitit 2022 janë zhvilluar dy procedura të rekrutimit / lëvizje paralele/avancim. Konkretisht deri me 31.12.2022 është përmbyllura procesi dhe është zhvilluar me sukses një procedurë lëvizje paralele për pozitën udhëheqës i divizionit të shërbimeve të përbashkëta.

5. AKTIVITETET E KOMISIONIT RREGULLATIV TË PROKURIMIT PUBLIK

Në këtë pjesë të raportit paraqiten të dhënat mbi punën dhe aktivitetet kryesore të departamenteve të KRPP-së për periudhën raportuese dhe të cilat aktivitete kanë qenë në funksion të përmirësimit dhe avnecimit të sistemit të prokurimit publik në tërësi dhe në përmbushjen e objektivave të planifikuar dhe arritjen e rezultateve të pritura nga KRPP.

5.1 Aktivitetet e Departamentit të Rregullave

Aktivitetet e Departamentit të Rregullave për periudhën raportuese përfshijnë aktivitete në përputhje me LPP-në dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me LPP dhe kryesisht kanë qenë të fokusuar në:

- *Përditësimin e akteve dytësore, rregullave dhe udhëzimeve, si dhe formularëve Standard për unifikimin e praktikave në fushën e prokurimit publik dhe harmonizimin me direktivat e BE-së;*
- *Dhënien e opinioneve, këshillave apo udhëzimeve sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik;*
- *Dhënien e interpretimeve të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, sipas kërkesave të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik.*

Që nga fillimi i vitit 2022 e deri në përfundimin e tij, Departamenti i Rregullave ka punuar në ndryshim/plotësimin e akteve dytësore për t'i bërë ato më lehtësisht të zbatueshme për autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomik dhe për funksionim më të mirë të Platformës elektronike të Prokurimit Publik.

Si rrjedhojë, *Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik* përveç se përfshinë rregulla për rregullimin e çështjeve të caktuara me qëllim të zbatimit të drejtë të parimeve themelore të prokurimit publik dhe arritjes së së vlerës për para, e njëjta është edhe një përmbledhje e disa akteve dytësore në një dokument (*Rregullat për Shërbime të veçanta, Rregullat për çmime jonormalisht të ulëta, rregullat për trajnime, Rregullat për parashtrim të ankesave dhe Rregullorja Nr. 2/2017 për procedurat e dhënies dhe Revokimit të Certifikatës profesionale për Prokurim Publik*) dhe kështu është bërë më i lehtë i qasshëm për përdorim për të gjitha palët e interesuara.

Në këtë kontest, vlen të përmenden disa nga ndryshimet e bëra me dispozitat e poshtëshënuara të Rregullores për Prokurimin Publik, zbatimi i të cilave do të ndikojë dukshëm në arritjen e vlerës për para, si dhe respektimin e parimeve themelore të prokurimit publik (*Parimi i efikasitetit dhe ekonomicitetit, trajtimi i barabart – jodiskriminimi, rritja e transparencës dhe e konkurrencës*), si në vijim:

- Neni 54.15 lidhur me kontratat publike kornizë me çmime njësi i cili kufizon shpenzimin e mjeteve buxhetore deri në vlerën e parashikuar të kontratës, sipas të cilit nën Kontrata publike kornizë lidhet me çmime për njësi dhe realizohet deri në vlerën e parashikuar. *(kjo rregull është vendos me qëllim të ndalimit të keqërpërdorimit të mjeteve buxhetore duke lidhë kontratë publike kornizë me vlerën e parashikuar 50.000,00 euro dhe deri në datën e skadimit (36 muaj) kontrata ka përfunduar me shpenzimin e mjeteve në vlerë prej 500,000.00 euro).*
- Neni 42.4 i cili rregullon afatin kohor për nënshkrimin e kontratave publike *(brenda 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës)* Një afat i tillë kohor për nënshkrimin e kontratave publike është përcaktuar me qëllim të eliminimit të praktikave jo të mira ku operatorët ekonomik janë detyruar të presin disa muaj deri sa kontratat janë nënshkruar edhe nga ZKA i autoriteteve kontraktuese.
- Neni 71, i cili përcakton qartë dhe në mënyrë taksative rastet kur mund të bëhen ndryshime në kontratë gjatë ekzekutimit të saj. Ky nen shprehimisht ndalon ndryshimet thelbësore në kontratë gjatë ekzekutimit të kontratës së tillë nga palët kontraktuese.

Neni 42.2 i cili obligon AK-të që në *Procedurat e Negociuara pa Publikimin e Njoftimit të kontratës*, që pas rekomandimit për dhënie të kontratë të publikojë menjëherë B58 Njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe B08 Njoftimin për dhënie të kontratës. Kjo rregull është vendos me qëllim të inofrmimit të palëve të interesuara me vendimin e autoritetit kontraktues dhe me këtë është krijuar mundësia e atakimit të vendimeve të tilla nga palët e pakënaqura.


Gjithashtu, departamenti ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në dhënien e këshillave, opinioneve dhe interpretimeve me shkrim palëve të interesuara (autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik) përmes arkivit të KRPP-së dhe adresës zyrtare elektronike “rregullat.krpp”, por edhe përmes telefonit zyrtar, si dhe përmes konsultave me prezencë fizike në zyrat e KRPP-së.

Nga aktivitetet e Departamentit të Rregullave për periudhën raportuese veçojmë:

- Përgaditja dhe nxjerrja e *Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik* e cila ka hyrë në fuqi me 01.11.2023
- Draftimi i Udhëzuesit për Prokurimin Publik (për t’u finalizuar dhe hyrë në fuqi gjatë vitit 2023)
- Përditësimi i ‘Pyetjeve të shpeshta’ me publikimin e 8 (tetë) interpretime ligjore duke shtuar numrin e përgjithshëm të interpretimeve ligjore në gjithësej 95 deri në fund të periudhës raportuese, dhe të cilat kanë ndihmuar autoritetet kontraktuese në zgjidhjen e probleme në situata të caktuara dhe/ose për zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore të LPP-së dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të LPP.
- Themelimi i “tavolinës ndihmëse” me qëllim të ofrimit të këshillave profesionale, interpretime të dispozitave të ligjit dhe të legjislacionit dytësor, me kërkesë të autoriteteve

- kontraktuese, operatorëve ekonomik, si dhe palëve tjera të interesuara çdo ditë pune në tel. + 383 (0) 38 213 709, si dhe në e-mail: rregullat.krpp@rks-gov.net;
- Ofrimi në total i tremijë e treqind e gjashtëdhjetë (**3.360**) këshilla/interpretime përmes arkivit të KRPP-së, adresës zyrtare (elektronike) “info.krpp”, drejtpërdrejtë në konsulta, si dhe përmes telefonit për autoritete kontraktuese, operatorë ekonomik, si dhe palë tjera të interesuara;
 - Ri-konfigurimi dhe përditësimi i “pyetjeve të shpeshta” të publikuara në ëeb faqen e prokurimit elektronik, duke ndare dhe përditësuar “pyetjet e shpeshta” në vetëm 20 - “interpretime” dhe 10 - “opinione”. Me këtë ri-konfigurim dhe përditësim është bërë shfuqizimi i interpretimeve dhe opinioneve të cilat kanë pësuar ndryshime me përditësimin e legjislacionit dytësorë në ndërkohë.
 - Ngritje e bashkëpunimit dhe ofrimit të ndihmës me keshilla, interpretime, opinione, etj, për institucionet tjera, veçanarisht me Agjencinë Kundër Korrupsion (5) raste të të hetimit dhe parandalimit të korrupsionit, Agjencinë Qendrore të Prokurimit (2)raste, Zyrën Kombëtare të Auditimit (2) raste, Njësitë për hetimin e Krimeve Ekonomike (PK) 30 raste të hetimit,, OSHP (7) raste, Prokuroritë, Gjykatat si dhe me OJQ-të.

Rreth numrit të interpretimeve të përgaditura dhe lëshuara nga departamenti i rregullave në kërkesat e Autoriteteve kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomik, më poshtë në Grafikon Nr.1 do paraqitet numri i kërkesave gjatë periudhës raportuese (2022) dhe gjithashtu për krahasim numrin e kërkesave nga dy vitet paraprake 200 dhe 2021.



Grafiku 1

5.2 Aktivitetet e Departamentit të Monitorimit

Aktivitetet e Departamentit të Monitorimit për periudhën raportuese përfshijnë aktivitetet në përputhje me kompetencat ligjore të departamentit, respektivisht 81, 88.1 dhe 88.2 të LPP-së nr.04/L-042 në bazë të të cilave departamenti i monitorimit dhe mbikëqyrjes ka kompetencë, autoritet dhe përgjegjësi të vëzhgoj, mbikëqyrë dhe monitoroj zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit dytësorë të nxjerrur nga KRPP-ja sipas autorizimit të këtij ligji.

Bazuar në kompetencat ligjore dhe objektivat e institucionit për periudhën raportuese, aktivitetet e departamentit të monitorimit janë fokusuar në:


- monitorimin e aktiviteteve të prokurimit të zhvilluara nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese, duke filluar nga faza e inicimit deri në fazën e përmbylljes së aktivitetit
- aplikimin e metodës së monitorimit të njoftimeve gjatë inicimit dhe fazës së tenderimit të aktivitetit të prokurimit, si masë preventive, me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të shkeljeve eventuale të LPP dhe legjislacionit dytësorë gjatë publikimit të njoftimeve
- aplikimiin e veglës për monitorim nga ana e zyrtarëve të monitorimit për monitorim të aktiviteteve të prokurimit që nga faza e inicimit bazuar në indikatorë të përzgjedhur dhe me prioritet
- evidentimin e shkeljeve më të shpeshta nga ana e Autoriteteve Kontraktuese, shkelje të evidentuara sipas Autoritetit Kontraktues, llojit dhe vlerës së procedurës së prokurimit dhe dispozitat ligjore të shkelura
- dhënia e opinioneve, rekomandimeve dhe këshillave për AK-së në shkeljet të dispozitave ligjore të evidentuara gjatë fazave të monitorimit, sidomos në shkeljet e neneve 7.3, 9.5, 28.7, 68.1, 69 dhe Nenit 35 për përdorim të Procedurës së prokurimit pa publikim të Njoftimit për kontratë.
- evidentimi i procedurave të anuluar dhe arsyeve për anulim
- zgjerimi i monitorimit të aktiviteteve të prokurimit deri në përmbyllje të kontratës (monitorim nga procesi administrativ);
- monitorim me prioritet i përdorimit në procedurën e negociuar pa publikim.

Të gjitha të dhënat e evidentuara nga aktivitetet e monitorimit për periudhën raportuese janë paraqitur me poshtë në tabelat dhe grafikonet përkatëse.

Të dhëna mbi numrin e monitorimeve sipas llojit të procedurës, njoftimit dhe vlerës së procedurës/kontratës

	Vlerë e madhe	Vlerë e mesme	Vlerë e vogël	Vlerë minimale	Kontrat kornizë me një	Kontrat kornizë me	Gjithësej
Njoftime për kontratë	557	2348	1121	16	287		3942
Njoftim për dhënie të kontratës	241	1176	526	10			1953
Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit	142	470	214	11			837
Njoftim paraprak	15						15
Njoftim mbi rezultatin e konkursit të projektimit		3					3
Njoftim mbi konkursin e projektimit	4	12	2				18
Njoftim për anulimin e dhënies së kontratës	2	2	1				5
Njoftim për parakualifikim		1					1
Njoftim për informata shitesë ose përmirësim gabimi	204	321	50	1			576
Njoftim për procedurën e negociuar pa publikim	95	158	66				319
Ftesë për ofertim-shitje							
Njoftim për nënshkrim të kontratës	206	1015	411	164			1796
Njoftim i vendimit të AK para publikimit sipas nenit 43 dhe 44.2 të RRUPP	208	912	371	2			1499
Ngarkimi i kontratës në sistem të prokurimit elektronik	46	177	62	9			294
Shitja e aseteve – Ankande							
Shërbime të konsulencës		9	7				16
Gjithësej	1720	6604	2831	213	287		11274

Tabela 3



Grafiku 2


Siq shihet nga grafiku nr.2 në vitet 2020 dhe 2021 kemi rënie të numrit të përgjithshëm të njoftimeve të monitoruara ndërsa në vitin 2022 kemi një ngritje prej **3166** njoftimeve në raport me vitin 2021.

Nenet e LPP-së, me numrin më të madh të intervenimeve të evidentuara gjatë vitit- 2022		
Neni	Përshkrimi	Raste
Neni 9.5	Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së mjeteve	49
Neni 68.1	Gjendja eko.dhe financiare (Përzierje e kërkesave me dëshmi	47
Neni 69	Aftësitë teknike dhe profesionale	37
Neni 7.3	Barazia në trajtim, jodiskriminimi	30
Neni 69.1	Aftësitë teknike dhe profesionale (Kërkesat kualifikuese	23
Neni 27.8	Specifikimi teknik	22
Neni 69.4	Aftësitë teknike dhe profesionale (Lista e kontratave për shërbime- 3 vitet e fundit)	20


Tabela 4

Neni i LPP me numrin më të madh të intervenimeve gjatë vitit 2022		
Neni	Përshkrimi	Raste
Neni 69	Aftësitë teknike dhe profesionale	37
Neni 69.1	Aftësitë teknike dhe profesionale - Kërkesat kualifikuese	23
Neni 69.2.1	Aftësitë teknike dhe profesionale - lista e furnizimeve kryesore në tre vitet e fundit	12
Neni 69.2.2	Aftësitë teknike dhe profesionale - masat e sigurimit të cilësisë/ISO standardet	1
Neni 69.2.5	Aftësitë teknike dhe profesionale - çertifikatat nga instituti për kontroll të cilësisë	11
Neni 69.4.1	Aftësitë teknike dhe profesionale - kualifikimet shkollorë dhe profesionale	8
Neni 69.4.2	Aftësitë teknike dhe profesionale - lista e kontr. të realizuara në tri vitet e fundit	20
Neni 69.4.3	Aftësitë teknike dhe profesionale - nuk është kërkuar parakontrata	1
Neni 69.4.4	Aftësitë teknike dhe profesionale - raporti mbi mjetet, stabilimentet ose paisjet	9
Neni 69.6.1	Aftësitë teknike dhe profesionale - kualifikimet shk. dhe profes. të personelit udhëheqës	18
Neni 69.6.2	Aftësitë teknike dhe profesionale - Lista e projekteve të punëve ndërtimore	3
Neni 69.6.3	Aftësitë teknike dhe profesionale	9
Neni 69.6.4	Aftësitë teknike dhe profesionale	10
Neni 69.8	Aftësitë teknike dhe profesionale	1

Tabela 5




Grafiku 3



Grafiku 4

Monitorimi i Njoftimeve për anulim të aktivitetit të prokurimit	
Arsyeja e anulimit	Raste
Nuk është dorëzuar asnjë ofertë- tender	237
Nuk ka asnjë ofertë të përgjegjshme	170
Anulim për shkak të tejkalimit të buxhetit	134
Anulim para hapjes së ofertave për shkak të ngjarjeve apo arsyeve objektive dhe të domosdoshme të cilat janë jashtë kontrollit të AK dhe të cilat kanë qenë të paparashikuara në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit	91
Një dispozitë e ligjit kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit	98
Një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në proc.e prok.e cila nuk mund të rregullohet apo parandalohet përmes një amandamenti ligjor të prokurimit	10
Në bazë të nenit 108/A, paragrafi 10.2 i LPP-së	1
Me vendim të OSHP-së	42
Anulimi është bërë për shkak se nuk janë dërguar çelësat anëtarve të komisionit për hapje	3
Anulimi është bërë për shkak se OE fitues është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës	1
Anulimi për shkak të gabimeve në specifikacionin teknik	1

Tabela 6




Grafiku 5

Nga të dhënat mbi monitorimin e njoftimeve për anulim, është evidente se në vitin 2022 janë monitoruar rreth 788 raste, që tregon një rritje të dukshme të aktivitetit të monitorimit në krahasim me vitet paraprake për rastet e anulimit të aktiviteteve të prokurimit.

Monitorimi i Procedurave të Negociuara pa Publikim të Njoftimit për Kontratë - Departamenti i monitorimit gjatë vitit-2022, nga AK ka pranuar njoftimet për këtë lloj të procedurës si në vijim:

- 319 raste (procedura)
- 7 raste, punë shtesë (deri në 10% të kontratës bazë)



Grafiku 6

Monitorimi i njoftimeve me Çmim anormalisht të ulët - Neni 61 të LPP-së –Nr.04/L-042

- 3 raste, çmimi anormalisht i ulët

Monitorimet sipas rastit	
Përshkrimi i monitorimit	Raste
Rekomandime për përmirësimin e kërkesave	375
Opinione për përmirësimin e kërkesave	27
Përgjigje sipas kërkesës të OE apo palëve të interesuara	29
Monitorim sipas rastit, kërkesës	5
Raporte për qasje në dokumente publike	2
Kërkesa për sqarim	3
Opinione për PNPPNJK	46

Tabela 7

Autoritete Kontraktuese me numrin –përqindjen (%) më të madhe të intervenimeve

Ndërhyrjet dhe intervenimet: Nr. më i madh i ndërhyrjeve dhe intervenimeve gjatë vitit 2022 ka qenë tek autoritetet kontraktuese si më poshtë:

Autoriteti kontraktues	Njoftime e publikuara	Njoftimet e monitor.	% e nr. të AP të monitoruara	Numri i Intervenimeve	Intervenimet në %
Komuna e Vitisë	74	32	43.2%	19	59.37%
Ministria e Infrastrukturës	26	17	65%	7	41%
Zyra e Presidentit të RKS	21	19	90.47%	7	36.84%
Komuna e Malishevës	87	57	65.51%	19	33.33%
Administrata Qëndrore – Ministria e Transfereve Punës dhe Mirqenjes Sociale	56	37	66.02%	12	32.43%
Ministria e Arsimit	52	41	78.85%	13	31.70%
AMKM	57	47	82.46%	14	29.79%
Komuna e Glogocit	107	83	77.57%	21	25.30%
Komuna e Ferizajit	131	53	40.6%	13	22.64%
Universiteti i Prishtinës	68	45	66.17%	9	20%
Komuna e Kaçanikut	87	61	70.11%	12	19,67%
Komuna e Kamenicës	57	32	56.14%	6	18.75%
Komuna e Istogut	105	61	58.09%	11	18.03%
Komuna e Skenderajt	87	46	52.87%	8	17.39%
Komuna e Prishtinës	173	125	72.24%	11	8.8%
Komuna e Vushtrrisë	114	82	71.92%	7	8.5%
Komuna e Pejës	96	83	86.4%	7	8.4%
Komuna e Mitrovicës	92	85	92.39%	7	8.23%
Komuna e Suharekës	144	120	83.3%	9	7.5%
KEK	422	256	60%	7	2.7%

Tabela 8

Anulimi i certifikatës profesionale të prokurimit dhe vërejtjet e shqiptuara për zyrtarët e prokurimit

Anulim të certifikatës: Gjatë vitit 2022. KRPP ka revokuar certifikatën profesionale të prokurimit të Zyrtarit përgjegjës të prokurimit(ZPP), në dy raste:

- Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit të AK - Universitetit të Prishtinës **z. Selman Qorri**, *Vendimi nr. 30/2022 i dt. 08.09.2022*, me kërkesë të U.D. Sekretarit të përgjithshëm Universitetit të Prishtinës.
- Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit të AK - Minisrtia e Shëndetësisë **z. Ismet Hyseni**, *Vendimi nr. 67/2022 i dt. 30.12.2022*, me kërkesë të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Vërejtje me shkrim: Gjatë vitit 2022. KRPP ka shqiptuar vërejtje me shkrim për Zyrtarë të prokurimit në tre (3) raste:

- Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit të AK – Posta e Kosovës **z. Hasim Krasniqi**, *Vendimi nr. 14/2022 i dt. 28.03.2022*, me kërkesë të Departamentit të Monitorimit
- Zyrtarit të Prokurimit të AK- Minisrtia e Shëndetësisë **z. Berat Marmullaku**, *Vendimi nr. 67/2022 i dt. 30.12.2022*, me kërkesë të Organit Shqyrtues të Prokurimit
- Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit të AK – Komuna e Suharekës **z. Fatos Kuqi**, *Vendimi nr. 68/2022 i dt. 30.12.2022*, me kërkesë të Departamentit të Monitorimit

Paralajmërimi: Gjatë vitit 2022. KRPP ka paralajmëruar Zyrtarë të prokurimit në një rast:

- Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit të AK – Komuna e Malishevës **z. Nuhi Shalaj**, *Vendimi nr. 15/2022 i dt. 02.03.2022*, lëshuar nga Departamenti i Monitorimit

Refuzime të kërkesave: Gjatë vitit 2022 KRPP ka refuzuar si të pabazë kërkesat në dy raste:

- Ish Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit të AK – Komuna e Suharekës **z. Afrim Bytyqi**, *Vendimi nr. 10/2022 i dt. 28.02.2022*, refuzohet si e pabazuar kërkesa të Departamentit të Monitorimit
- Zyrtarit përgjegjës të Prokurimit të AK – MKRS **z. Egzon Zariqi**, *Vendimi nr. 43/2022 i dt.20.10.2022*, refuzohet si e pabazuar kërkesa e Organit Shqyrtues të Prokurimit për revokimin e certificates.

Në kuadër të bashkëpunimeve me institucionet e tjera jatë vitit 2022 Departamenti i Monitorimit ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me institucionet tjera si: Agjencia Kundër Korrupsion, Agjensinë Qendrore të Prokurimit, Organin Shqyrtues të Prokurimit, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Njësitë për hetimin e Krimeve Ekonomike, OJQ-të si dhe me palët tjera të interesuara, duke ofruar asistencë në sqarimin dhe zbatimin e ligjit të prokurimit publik.

5.3 Aktivitetet e Departamentit të Trajnimeve

Në mbështetje të Ligjin Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, konkretisht sipas nenit 25 të LPP-së, KRPP-ja duhet të ndikoj në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore në prokurim publik nëpërmjet organizimit të trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm.

Departamenti për Trajnim dhe Integrim, sfidat dhe problemet e sistemit të prokurimit publik në Kosovë ka synuar të adresoj përmes programeve trajnuese për prokurim, qëllimi i të cilave është që të ofroj mbështetje dhe të bëjë më të lehtë punën e zyrtareve të prokurimit në zgjidhjen e problemeve ose gjetjen e zgjidhjeve në mënyrë më kreative dhe efikase brenda kornizës ligjore për prokurim.

Departamenti për trajnime dhe integritet ka ndërvepruar, bashkëpunuar dhe raportuar për çështjet që lidhen me prokurimin publik në proceset e Integritetit Evropian. Në këtë kontest KRPP-ja në vazhdimësi ka mbajtur takime, ka raportuar dhe bashkëpunuar me Institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare sa i përket fushës së prokurimit publik, me Departamentet/Zyrat përkatëse për Integritet Evropian në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM/DIE), MFPT, BE, OECD-SIGMA, Bankën Botërore dhe institucionet të tjera.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, Departamenti për Trajnim dhe Integritet Evropian ka ndërvepruar dhe bashkëpunuar në ofrimin e mbështetjes profesionale në procesin e hartimit të Strategjisë së Re për Reformën në Menaxhimin e Financave publike (SRMFP, 2022-2026) dhe Planit të Veprimit (2022-2026) për zbatimin e Strategjisë, pjesë e së cilës është edhe prokurimi publik.

Nga obligimi ligjorë i KRPP-së që të ndikoj në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve njerëzore në prokurim publik, Departamenti i Trajnimeve për periudhën raportuese ka ndërmarrë aktivitete në funksion të ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve në prokurim publik dhe në funksion të realizimit të objektivave të planifikuara në planin e performancës.

Aktivitetet kryesore të cilat janë ndërmarrë nga departamenti për trajnime për periudhën raportuese janë si në vijim:

- **Aktiviteti 1:** Rishikim i programeve/moduleve të trajnimit për nivele themelore profesionale për prokurim dhe të avancuara;
- **Aktiviteti 2:** Planifikim dhe organizim i trajnimeve për nivel themelor profesional për prokurim dhe të avancuar në prokurim publik.
- **Aktiviteti 3:** Vlerësimi i nevojave të AK-se dhe palëve të tjera për trajnim dhe certifikim në prokurim publik;

Rishikim i programeve/moduleve të trajnimit për nivele themelore profesionale për prokurim dhe të avancuara

Trajnimi themelorë profesional është program bazik për zyrtaret në zyrat e prokurimit të Autoriteteve Kontraktuese të cilët në mënyrë direkte apo indirekte marrin pjesë në aktivitetet e prokurimit. Programi themelorë profesional për vitin 2022 ka qenë i strukturuar në 15 module trajnimi si në vijim:

1. Ligji i Prokurimit Publik i ndryshuar dhe i amandamentuar.
2. Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik
3. Integriteti në prokurimin publik
4. Procedura e Hapur
5. Procedura e kufizuar
6. Procedura konkurruese me negociata
7. Procedura e negociuar pa publikim
8. Përgatitja e Dosjes së tenderit
9. Prokurimi i shërbimeve të përgjithshme
10. Prokurimi i shërbimeve - Konsulente
11. Kontratat publike kornizë
12. Menaxhimi i kontratës
13. Ankesat dhe procedurat e shqyrtimit
14. E- prokurimi – Përgatitja e dosjes, Zhvillimi i procedurës së prokurimit, Njoftimi për
15. Dhënie të Kontratës.
16. E- prokurimi - Dorëzimi i ofertës elektronike, Dorëzimi i kërkesave për Rishqyrtim në
17. AK dhe dorëzimi i Ankesës në OSHP.

Të gjitha këto module janë **rifreskuar dhe rishikuar nga departamenti për trajnim dhe janë publikuar në ëeb- faqen** e KRPP-së sipas të cilës çdo kush ka pasur qasje. Gjithashtu të gjitha materialet e trajnimeve ju janë dërguar të gjithë pjesëmarrësve në e- mail adresat e tyre në momentin që ka filluar trajnimi të zhvillohet.

Planifikim dhe organizim i trajnimeve për nivel themelor profesional për prokurim dhe të avancuar në prokurim publik

Trajnimi për nivel themelorë profesional

Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve për programin themelorë profesional për vitin 2022 është bërë nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP).

Duhet theksuar që në këtë trajnim, numri i aplikuesve të interesuar ishte prej 108 (101 nga institucionet publike, 4 OJQ, 2 shoqata, 1 operator ekonomik) zyrtareve prej të cilëve 69 zyrtarë kanë qenë të kompletuar në dokumentacion sipas kushteve të përcaktuara në njoftimin për aplikim në trajnim të publikuar në ëeb- faqe të KRPP-së gjatë muajit nëntor /2022. Ndërsa 39 zyrtarë tjerë kanë qenë të pa kompletuar në bazë të raportit të vlerësimit nga komisioni për vlerësime të aplikacioneve.

Trajnimi ka filluar me datën 15.12.2022 dhe ka përfunduar me 18.01.2023, trajnimin e kanë përcjell 68 zyrtarë ndërsa testin e kanë kaluar 43 të cilët janë pajisur me certifikatë themelor profesional për prokurim /2023-2025.

Të gjitha fazat: njoftimi për dorëzim të aplikacioneve, procesi i vlerësimit të aplikacioneve, procesi i trajtimit të ankesave, njoftimi për fillimin e zhvillimit të trajnimit, organizimi dhe mbajtja e moduleve të trajnimit, njoftimi për ditët e vijimit të trajnimit, njoftimi për procesin e testimit, mbajtja e testit, vlerësimi dhe publikimi i rezultateve të testit dhe në fund pajisja me certifikatë themelore profesional për prokurim publik janë bërë nga Departamenti /Divizioni i trajnimeve në bashkëpunim me IKAP.

Trajnimi për nivel të avancuar profesional

Trajnim i organizuar nga KRPP-ja për Policinë e Kosovës

Gjatë vitit 2022 – KRPP-ja ka filluar një cikël të trajnimit duke u mbështetur në bashkëpunimet ndër-institucional në mes të KRPP-së dhe Autoriteteve Kontraktuese, të cilat trajnime kanë pasur për qëllim ngritjen dhe avancimin e njohurive të zyrtareve të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Një organizimi i trajnimit të tillë ka qenë trajnimi i organizuar nga KRPP-ja për Policinë e Kosovës.

Ky trajnim është mbajtur gjatë muajit gusht të vitit 2022, duke u mbështetur në kërkesat e zyrtarëve të Policisë së Kosovës që kanë pasur objektivat siç janë :

1. Ligjin e prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar dhe rregullorja për prokurim publik
2. Përgatitja e specifikimeve teknike dhe funksionale dhe Kontratat Kornizë – Llojet,
3. Tenderi ekonomikisht me i favorshëm /TEMF dhe Vlerësimi i tenderit duke përdorur kriteret e peshuara
4. E- prokurimi / Menaxhimi i Kontratave dhe Vlerësimi i performancës së OE në platformën elektronike

Për këtë program të trajnimit KRPP-ja ka përcaktuar – angazhuar 5 trajner të cilët i kanë mbajtur 8

ditë trajnim për dy grupe të pjesëmarrësve, ku secili grup ka pasur më shumë se 30 pjesëmarrës. Trajnimi ka filluar në muajin gusht dhe ka përfunduar në shtator të vitit 2022, konkretisht me datën 08.09.2022 kemi bërë shpërndarjen e Certifikatave për pjesëmarrje për me se **57 zyrtarë të Policisë** të cilët kanë qenë pjesëmarrës mbi tre ditë të trajnimit nga katër ditë gjithësej.

Edhe për këtë trajnim KRPP-ja ka përgatit listën e pjesëmarrësve për nënshkrim dhe agjendën sipas të cilës janë mbajtur modulet e trajnimit. Trajnimi tetë ditor me Policinë e Kosovës është mbajtur në objektin e Policisë së Kosovës, ku si pjesëmarrës ishin 72 zyrtarë.

Trajnim i organizuar në bashkëpunim me Integritet Evropian

Ne baze të nevojave të identifikuar për ngritje të kapaciteteve në përdorimin e kriterit për dhënie të kontratave në prokurim publik, kriterit Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm (TEMF), gjatë vitit 2022 – KRPP-ja në bashkëpunim me Zyrën për Kriteria Ekonomike dhe Treg të Brendshëm/ZKM, ka mbajtur trajnim për përdorim të kriterit TEMF.

Trajnimi është organizuar për stafin e 3 Institucioneve Qendrore të Prokurimit, Zyrës Kombëtare e Auditimit dhe për stafin e disa nga AK-se, me buxhet me të madh dhe me specifike.

Nga dt. 05-08.07.2022, është mbajtur trajnimi 4 ditor, për 4 grupe pjesëmarrësish, që kanë përfshirë gjithësej 61 pjesëmarrës. Trajnimi është mbajtur nga një ekspert ndërkombëtar i angazhuar, në kuadër të projektit mbështetës, " KSV 019 Asistenca teknike në kontekst të Integritet Evropian" i cili po ashtu ka përgatitur dhe dorëzuar në KRPP, draftet e Manualit dhe Udhëzimit Administrativ për përdorim të kriterit TEMF të cilat dokumente pas aprovimit nga KRPP do të bëhen pjesë e legjislacionit dytësorë.

Zyrtarët që kanë marrë pjesë në trajnim janë nga institucionet, si:

- 3 Institucionet Qendrore të Prokurimit (KRPP-se, OSHP, AQP).
- Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).
- 8 Ministri (Ministria e Shëndetësisë, MPPH, MTI, MASHT, Ministria e Mbrojtjes, MFPT, MKRS, MPB).
- 7 Komuna (Komuna e Ferizajt, Komuna e Mitrovicës, Komuna e Prishtinës, Komuna e Prizrenit, Komuna e Pejës, Komuna e Gjilanit, Komuna e Gjakovës).
- 4 Ndërmarrje Publike (KEK, KOSTT, KRU-Prishtina, KRM -Pastrimi, Trepça. Sh.a), dhe
- 7 Autoritete tjera siç janë: (Policia e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, QKUK, ZKA, Dogana e Kosovës, ZKM, UP-Hasan Prishtina).

Vlerësimi i nevojave të AK-se dhe palëve të tjera për trajnim dhe certifikim në prokurim publik

Departamenti për Trajnim dhe Integrim ka bërë vlerësimin e nevojave të AK për trajnime duke marrë parasysh kërkesat të cilat janë drejtuar me shkrim në KRPP dhe anketës së shpërndarë nga KRPP në mbështetje të projektit me Ambasadën e Anglisë. Anketa është shpërndarë në gjysmën e dytë të vitit 2022 të 900 zyrtarëve të Autoriteteve Kontraktuese (AK)¹ dhe 2,400 Operatorë Ekonomik (OE)².

Duke analizuar rezultatet e anketës dhe kërkesat e adresuara me shkrim në KRPP të cilat kanë qenë të orientuara kryesisht për modulet e trajnimit **Menaxhimi i Kontratës dhe Vlerësim i performancës** së kontraktoreve përmes sistemit të e-prokurimit, departamenti i trajnimeve ka vlerësuar nevojat dhe ka filluar mbështetjen ndaj Autoritetet Kontraktuese sipas kërkesave

Në mbështetje të kësaj si dhe duke konsideruar që me vënien në përdorim të dy (2) këtyre moduleve përmes e-prokurimit, ngritet efikasiteti, transparencja dhe niveli i llogaridhënies gjatë implementimit të kontratave në prokurimin publik nga të gjitha autoritetet kontraktuese në nivel të vendit dhe për të gjitha llojet e kontratave, KRPP-ja ka organizuar trajnime për këto module me Autoritete Kontraktuese siç janë:

- *Akademia e Kosovës për Siguri Publike*
- *Posta e Kosovës, sha.*
- *Ministria e Administrimit të Pushtetve Lokal.*
- *Ministria e punëve të jashtme dhe e Diasporës*
- *Komuna e Gjakovës*
- *Ministria e infrastrukturës*
- *Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*

Gjatë vitit **2022** KRPP duke filluar nga muaj prill – dhjetor ka mbajtur trajnime me AK dhe në baze të listës së pjesëmarrësve janë përgatit dhe dorëzuar edhe certifikatat për pjesëmarrje për të gjithë ata të cilët e kanë ndjekur trajnimin (178).

Në këto trajnime kanë marrë pjesë zyrtarët cilët kanë pasur pozita të ndryshme në AK – siç janë menaxher prokurimi, zyrtarë prokurimi, menaxher të kontratës, zyrtar të lartë administrativ, zyrtar të TI, Zyrtare Financiar, etj.

Pjesëmarrësit në trajnim kanë diskutuar për praktikën më të mirë dhe vështirësitë më të cilat përballen

¹ https://www.surveymonkey.com/stories/SM-pTgGKRinZzfi9xFyQjG1_2Fg_3D_3D/

² https://www.surveymonkey.com/stories/SM-9b_2B8VkaUmR4ACzkqgrkhCw_3D_3D/

zyrtaret në proceset e menaxhimit të kontratave në platformën e prokurimit elektronik. Trajnimi ka qenë i pasur me shembuj dhe studime të rasteve nga praktikat vendore dhe ndërkombëtare për menaxhim të kontratës në e-prokurim.

Duhet theksuar që të gjitha trajnimet e mbajtura gjatë vitit 2022, kanë ndikuar dukshëm në ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve të zyrtarëve të AK të Kosovës në fushën e sektorit të prokurimit publik dhe sidomos në menaxhimin e kontratave.

Sektorit të prokurimit publik gjatë vitit 2022 i janë shtuar edhe 43 zyrtarë të pajisur me certifikatë themelore profesionale në prokurim, duke ngritur numrin e përgjithshëm të zyrtarëve të çertifikuar në prokurim në 968, duke bërë që të plotësohen nevojat e AK të cilat kanë pasur nevojë për certifikimin e zyrtarëve të tyre me certifikatë themelore profesionale për prokurim.

Ndërsa, sipas planifikimeve dhe adresimit të kërkesave dhe nevojave të Autoriteteve Kontraktuese, gjatë vitit 2022 rreth 379 zyrtarë të Autoriteteve Kontraktuese kanë ndjekur në përgjithësi të gjitha trajnimet e lartcekura nga departamenti i trajnimeve në KRPP, të cilat kanë ndikuar në rritjen e përdorimit të të kriterit të dhënies “Tenderi me çmimin ekonomikisht më të favorshëm dhe përdorimit të modulit të menaxhimit të Kontratave dhe vlerësimit të Performancës nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik krahasuar me vitin paraprak që ishte në një përqindje më të vogël të përdorimit.

5.4 Aktivitetet e Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik

Me aplikimin e prokurimit elektronik, KRPP përveç mandatit rregullator të prokurimit është shndërruar edhe në ofrues të shërbimeve nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, sistem i cili është i rëndësishë dhe ndjeshmërisë së veçantë, kërkon disponueshmëri dhe siguri të lartë, është një nga sistemet e teknologjisë informative me përdorim dhe shtrirje më të gjerë në nivel qeveritar.


Këtë mandat dhe ofrim të shërbimeve, KRPP e kryen nëpërmjet Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik, që gjatë vitit 2022 dhe në vazhdimësi si qëllim dhe objektiv kryesorë ka mbajtjen e sistemit të prokurimit elektronik plotësisht të operueshëm dhe funksional në mënyrë që të gjitha aktivitetet e prokurimit nga Autoritetet Kontraktuese të realizohen në mënyrë sa më efektive dhe efikase.

Në këtë pjesë të raportit, përveç aktiviteteve të Departamentit të Sistemit të Prokurimit Elektronik të cilat kanë për qëllim operimin dhe funksionimin e pandërprerë të sistemit të prokurimit elektronik dhe përmbushjen e objektivave të planifikuar në planin e performancës së KRPP-së, do të paraqiten edhe të dhëna statistikore të cilat janë pjesë e sistemit.

Ndër aktivitetet kryesore të departamentit të sistemit të prokurimit elektronik, veçojmë:

- Administrimin e përditshëm të infrastrukturës harduerike dhe softuerike të sistemit të prokurimit elektronik, parandalimin, evitimin dhe zgjidhjen e problemeve për të siguruar qëndrueshmëri dhe operim të pandërprerë të Sistemit të Prokurimit Elektronik, 24 orë në 7 ditë të javës
- Ofrim të shërbimeve në dhënie të ndihmës teknike dhe instruksioneve nëpërmjet tavolinës ndihmëse (linjë telefonike, postë elektronike dhe prezencë fizike) për të gjithë përdoruesit e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik gjatë përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik
- Aplikimin e procedurave standarde të TI-së në ruajtje dhe arkivim në bazë ditore të të dhënave të sistemit të prokurimit elektronik
- Dhënie të ndihmës teknike dhe mbështetjes për të gjithë stafin e KRPP-së, departamentin e rregullave, monitorimit dhe trajnimeve, në funksion të rritjes së njohurive në përdorim të funksionaliteteve të sistemit të prokurimit elektronik dhe transformimit nga prokurimi tradicional në atë elektronik
- Bashkëpunim dhe koordinim me institucionet e Ministrisë së Punëve të Brendshme/Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit dhe Ministrisë së Financave, si institucione të përfshira në mënyrë direkte dhe indirekte në operim të sistemit të prokurimit elektronik
- Pasurim i portalit <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>, me informacione, pyetje të shpeshta, njoftime dhe vendime të përgatitura nga KRPP dhe publikuar për publikun e gjerë
- Avancim dhe përmirësim të funksioneve të sistemit të prokurimit elektronik me qëllim të ri-strukturimit të dokumenteve në aktivitetet e prokurimit nga ana e AK-se dhe OE, përfshirë thjeshtësimin e përgaditjes dhe dorëzimit të ofertave nga ana e OE. Ky avancim është vënë në


- përdorim nga data 01.11.2023 me hyrjen në fuqi të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.
- Përgaditja dhe publikimi i Manualeve Udhëzuese për AK dhe OE lidhur me përditësimet e aplikuara nga data 01.11.2022.
 - Përmbyllja e kontraktimit për mirëmbajtje të sistemit të prokurimit elektronik: Kontrata me Nr. UA/2016-21 -8388-2-1-1/C227 është nënshkruar me datë 22.04.2022 me një kohezgjatje prej 24 muaj dhe në vlerë 299,961.90 euro
 - Avancimi i infrastrukturës harduerike të sistemit të prokurimit elektronik – pjesa e sajtit sekondar: realizuar nëpërmjet paisjeve të furnizuar me kontratën Nr. UA/2016-21-4907-1-2-1/C177 (Server dhe Storage) dhe vlerë prej 47,675.00 Euro.
 - Avancim i platformës së prokurimit elektronik me modulën e përditësuar të OSHP-së (sistemin e ankesave) nëpërmjet projektit të ambasades së Mbretërisë së Bashkuar, avancim i cili ka përfshirë: përgatitjen e Termave të Referencës dhe specifikimeve teknike në koordinim me OSHP dhe projektin e ambasades së UK, lidhja e kontratës me kontraktuesin për zhvillim dhe implementim të projektit, dhe Implementim i përditësimeve të modulit të OSHP-së në ambientin testues (dhjetor 2022), përfshirë trajnimin e përdoruesve të modulit si nga ana e AK-së, OE dhe OSHP-së, me synim për vënien në përdorim në fillim të 2023.
 - Avancim i ëeb aplikacionit për publikim të të dhënave sipas standardit për të dhëna të hapura edhe me të dhënat e kontratave në implementim – përveç të dhënave të prokurimit
 - Publikimi i ndryshimeve në ëeb-aplikacion dhe dhenia e instruksioneve për përdorim nga të gjitha palët e interesuara në <https://ocdskrpp.rks-gov.net/Help>.
 - Vënie në përdorim të veglës për monitorim të aktiviteteve të prokurimit nga ana e zyrtarëve të monitorimit të KRPP-së, monitorim i bazuar në indikatorë të përzgjedhur (si në fig më poshtë)




Të dhëna statistikore: Nga të dhënat statistikore aktuale për periudhën raportuese listojmë:

- Të gjitha ofertat në aktivitete të prokurimit janë përgaditur dhe dorëzuar nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik gjatë vitit 2022– rreth **29,000** oferta në të gjitha procedurat.
- Janë **(208)** AK të regjistruara dhe aktive në platformën e prokurimit elektronik merreth 16,300 përdorues
- Ka arritur në rreth **14,400** numri i OE të regjistruar të cilët përdorin platformën në mënyrë aktive
- Numri i të gjithë përdoruesve të regjistruar ka arritur në rreth **36, 000** (përfshirë personat fizik)
- **27, 000** publikime të të gjitha llojeve (në 2022) nga **121,000** publikime që deri më tani janë pjesë e platformës;
- **11,140** procedura të prokurimit janë zhvilluar (përgaditur dhe publikuar), nga të cilat rreth **9,042** kanë përfunduar me njoftim për nënshkrim kontrate.

Më poshtë janë paraqitur disa të dhëna statistikore mbi numrin e përdoruesve, AK-se dhe OE aktual dhe aktiv në sistem te prokurimit elektronik



Grafiku 7




Grafiku 8


Statistikat e publikimeve të të gjitha njoftimeve dhe ofertave të dorëzuara gjatë viteve 2020-2022			
Lloji i njoftimit	Nr 2020	Nr 2021	Nr 2022
Njoftim paraprak	78	66	59
Njoftim për kontratë (B05)	5874	6222	7548
Njoftim standard për korrigjim të gabimeve në njoftimet e publikuara (B54)	1412	1311	1685
Njoftim për konkurse të projektimit (B06)	27	25	32
Njoftim për dhënie të kontratës (B08)	5,646	5,475	6,212
Njoftim për nënshkrim të kontratës (B52)	5,389	6,196	9,042
Njoftim për rezultatet e konkursit të projektimit (B09)	18	20	24
Njoftim për anulim të aktivitetit të prokurimit (B10)	1,300	1,680	2,240
Kërkesa për sqarime-informacione shtesë	2,960	2,800	2,750
Kërkesa për rishqyrtim në AK	2679	2,440	2,479
Ankesa në OSHP	1,152	887	798
Oferta të dorëzuara nga OE në të gjitha aktivitetet e prokurimit	25,500	24,500	29,000

Tabela 9

Në tabelën më poshtë, janë paraqitur edhe disa të dhëna lidhur me llojin e publikimeve kryesore në sistem të prokurimit elektronik për gjatë viteve 2020-2022, dhe më pas edhe në formë të grafikut për Kërkesa për sqarime-informacione shtesë, Kërkesa për rishqyrtim në AK, Ankesa në OSHP dhe oferta të dorëzuara.



Grafiku 9



Grafiku 10

5.5 Aktivitetet e bashkëpunimit dhe përkrahjes nga donatorët

Sikurse në vitet paraprake edhe gjatë vitit 2022 KRPP ka vazhduar aktivitetet e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare nga të cilat ka përfituar përkrahje nëpërmjet projekteve të financuara nga institucionet respektive, si: USAID, EU, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar (UK), Qeveria e Luksemburgut, etj.

Edhe gjatë vitit 2022 bashkëpunimi dhe përkrahja nga donatorët ka qenë kryesisht në ofrimin e asistencës dhe shërbimeve të konsulencës dhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale të KRPP-se, për përmbushjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë të saj.

Përkrahja nga USAID: Gjatë vitit 2022 USAID nëpërmjet projektit të ri KMI (Kosovo Municipality Integrity) të implementuar nga DAI ka vazhduar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve për t'u përkrahur në KRPP.

Në lidhje me këtë bashkëpunim në korrik të 2022, KRPP dhe KMI/USAID kanë nënshkruar Memorandum të Mirëkuptimit me qëllim të formalizimit të bashkëpunimit ndërmjet Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe DAI/kontraktorit që zbaton Aktivitetin për Integritetin Komunal në Kosovë të financuar nga USAID-i. Në kuadër të mbështetjes së këtij projekti fokusi do të jetë në ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit në KRPP dhe AK-se, në mënyrë specifike mbështetjen me asistencë teknike dhe financiare në komponenten e monitorimit dhe prokurimit elektronik. KRPP dhe KMI/USAID fillimisht kanë hartuar një plani të aktiviteteve të cilat do të përfshihen në mbështetje nga projekti KMI/USAID, nga të cilat në 2022 duhet veçuar aktivitetin e angazhimit të një eksperti ndërkombëtarë në mbështetje të departamentit monitorimit në KRPP, dhe aktivitetin e ndërlikjes së sistemit të prokurimit elektronik me sistemin e Thesarit.

Përveç përkrahjes direkte të KRPP-së, duhet theksuar që projekti KMI/USAID ka për fokus kryesorë nivelin lokal (komunat) në përkrahje me ekspertizë në fushën e prokurimit, menaxhimit të kontratave, buxhetit, etj, në mënyrë që të ngritet niveli i integritetit dhe llogaridhënies në institucionet komunale.

Përkrahja nga EU: për periudhën raportuese EU nëpërmjet projektit për ndihmë teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë (të implementuar nga GIZ), ka vazhduar ofrimin e përkrahjes së asistencës teknike në fushën e legjislacionit primarë duke patur synim legjislacionin dytësor pas miratimit të Ligjit të Ri për prokurim publik.

Përkrahja nga Qeveria e Luksemburgut (KSV 019): Projekti Asistenca teknike në kontekst të integritetit evropian i zbatuar nga Zyra për Krite Ekonomike/Zyra e Kryeministrit dhe financuar nga Qeveria e Luksemburgut (KSV 019), ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve institucionale në administratën publike të Kosovës në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA. Në periudhën raportuese është vazhduar me ofrimin e përkrahjes në zhvillimin e kapaciteteve të KRPP-së dhe në fushën e prokurimit publik në përgjithësi, përmes ofrimit të punëtorive/trajnimeve si dhe në

përgatitjen e manualeve dhe udhëzimeve për sektorë të veçante në prokurim publik, që ndihmojnë një zbatim në mënyrë të duhur dhe sipas praktikave të mira evropiane të prokurimit publik. Në kuadër të kësaj mbështetje duhet theksuar asistencën me ekspertizë në përgatitjen e Manualit për përdorim të kriterit të dhënies “Oferta ekonomikisht më e favorshme” dhe mbajtjen e trajnimeve udhëzuese për përdorim të këtij kriteri.

Përkrahja nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar: Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar përkrahja dhe bashkëpunimi me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar (UK) në pajtueshmëri me Memorandum Mirëkuptimi për implementimin e projektit për avancim të modulit të OSHP-së brenda sistemit të prokurimit elektronik, projekt i cili është finalizuar me të gjitha fazat e testimeve gjatë fundit të vitit 2022, derisa fazat e tjera, trajnimi, manualët e përdorimit dhe vënja në funksion të plotë është planifikuar të bëhet gjatë fillimit të vitit vijues.

Përkrahja nga donatorë të tjerë potencial: Gjatë vitit 2022 KRPP ka zhvilluar aktivitete bashkëpunimi dhe diskutimi me Bankën Botërore në mënyrë që potencialisht gjatë vitit 2023 të shikohet mundësia e përkrahjes nga Banka Botërore në asistencë teknike/profesionale të vlerësimit të gjendjes aktuale në prokurim elektronik dhe jo vetëm, dhe sidomos në avancim të sistemit të prokurimit elektronik nëpërmjet projektit të BB i cili është në fazën përgatitore Projekti për Përforcimin e Qeverisjes Dixhitale për Ofrimit të Shërbimeve në Kosovë".

6. REKOMANDIMET DHE SFIDAT E KRPP-së

Sipas Nenit 87.2.13, të Ligjit për Prokurim Publik Nr. 04/L-042, KRPP-ja së bashku me raportin vjetor në Qeveri dhe Kuvend duhet të dorëzojë edhe rekomandimet për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe/ose përmirësimin e këtij ligji.

Sikurse viteve paraprake edhe me teje mbetet në proces që Qeveria e Kosovës përkatësisht KRPP si Institucion i autorizuar për fushën legjislative në Prokurimin Publik të ketë si objektiv dhe synim kryesorë reformat edhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, me qëllim të ngritjes së transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies nga të gjithë aktorët të cilët janë të përfshirë në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit publik.

Përkundër disa ndryshimeve/përditësimeve në legjislacionin dytësor që ka bërë KRPP gjatë vitit 2022 me draftimin, publikimin dhe vënien në fuqi të Rregullores së re të Prokurimit Publik dhe me të cilën është synuar eliminimi i dobësive të identifikuara gjatë zbatimit praktik të ligjit aktual, reforma kryesore në fushën legjislative apo aprovimi i Ligjit të ri të Prokurimit Publik edhe gjatë vitit 2022 ka mbetur ende në fazën finale të draftimit. Prandaj, edhe më tutje një nga synimet dhe rekomandimet kryesore gjatë vitit vijues mbetet miratimi i ligjit të ri të LPP në mënyrë që legjislacioni në prokurimin publik të jetë i:

- i) harmonizuar me Direktivat e reja të BE-së
- ii) harmonizuar plotësisht me legjislacionin për përdorim të mjeteve elektronike në prokurim, dhe
- iii) aplikueshëm për eliminimin e dobësive të identifikuara gjatë zbatimit praktik të ligjit aktual

Përveç rekomandimit që aprovimi dhe hyrja në fuqi të ligjit të ri të LPP-së në vitin vijues, KRPP ka paraparë edhe rekomandimet mbi fazat e mëtutjeshme të kësaj reforme të cilat duhet patur parasyshë para dhe pas aprovimit të Ligjit të ri të LPP.

Kryesisht, rekomandimet kanë të bëjnë me domosdoshmërinë që ndryshimet në legjislacionin primarë më tej do duhet të përcillen me ndryshimet në legjislacionin dytësor, të cilat KRPP duhet t'i bëjë në mbështetje të autorizimeve të veta dhe për të cilat ndryshime duhet të parashikohet dhe planifikohet një periudhë kohore si fazë kalimtare para fillimit të implementimit të ndryshimeve ligjore, dhe bazuar në kapacitetet aktuale të KRPP-së dhe domosdoshmërinë që ndryshimet ligjore të përshtaten plotësisht me mjetet elektronike (prokurimin elektronik), atëherë rekomandohet që kjo fazë kalimtare të jetë së paku në një kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh.

Mbështetur në arsyet e cekura shkurtimisht më lartë por edhe në shumë dimensionet tjera, në të cilat ndryshimet ligjore do të kenë efekte të cilat nuk është arritur të prezantohen në këtë raport, KRPP i rekomandon Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës që të përkrahin këtë reformë ligjore, derisa KRPP me departamentet përkatëse shprehë gatishmërinë për të qenë plotësisht në funksion të detyrimeve ligjore në implementim të kësaj reforme në prokurim publik dhe për të ofruar çfaredo sqarimi për të gjitha palët e interesit lidhur me këtë proces tejet të rëndësishëm për vendin.

Krahas rekomandimeve që kanë për synim ndryshimet ligjore, duhet evidentuar edhe rekomandimet për eliminim të dobësive të identifikuara gjatë zbatimit praktik të ligjit aktual të cilat janë reflektuar edhe në të dhënat statistikore të aktiviteteve të KRPP-së dhe kontratave të nënshkruar nga të gjitha Autoritetet Kontraktuese të paraqitura në këtë raport, dhe të cilat KRPP gjatë vitit 2022 ka synuar t'i adresoj me nxjerrjen dhe vënien në fuqi të Rregullores së re të Prokurimit Publik.

Nga dobësitë e evidentuara gjatë vitit 2022 dhe të cilat KRPP ka synuar që t'i adresoj me legjislacion dytësorë, janë:

- përdorimi jo i drejtë i kriterëve kualifikuese dhe vlerësuese nga ana e AK-se, të cilat kriterë kanë drejtuar aktivitetet e prokurimit në kufizim ose diskriminim të ofertuesve dhe të cilat kanë përfunduar me ankesa ose në mungesë të ofertave të përgjegjshme, që për pasojë kanë ndikuar edhe në rritje të numrit të aktiviteteve të anuluar;
- mungesa e tavanit buxhetorë në implementim të kontratave kornizë me çmime njësi, që për pasojë ka patur realizimin apo shpenzimin e mjeteve buxhetore shumëfish më shumë se sa buxheti i planifikuar;
- përdorimi i procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë me një OE edhe në rastet kur procedura nuk ka qenë subjekt i detyrimeve teknike objektive, të drejtës autoriale apo emergjencës ekstreme;
- vonesa të pa arsyeshme në nënshkrim të kontratave edhe pas vendimit mbi dhënien e kontratës dhe përfundimit të fazave të ankimimit;
- anulim të aktiviteteve të prokurimit si pasojë e veprimeve jo adekuate ose mosveprimeve të zyrtarëve nga autoritetet kontraktuese gjatë përdorimit të sistemit të prokurimit elektronik, mungesës së planifikimeve të prokurimit në mënyrë të duhur ose përgaditjes së aktivitetit të prokurimit – anulime të cilat kanë konsumuar kohë dhe kanë rezultuar me ri-tenderime
- vonesat në administrim të të dhënave në sistem të prokurimit elektronik nga ana e AK-se dhe OE gjatë implementimit/realizimit të kontratave të lidhura nëpërmjet procedurave të prokurimit
- paqartësi nga ana e AK-se dhe OE kontraktues lidhur me ndryshimin e kontratës gjatë fazës së implementimit – sidomos mungesë e njohurive në kualifikimin e ndryshimit të kontratës nëse ndryshimi është thelbësor ose jo-thelbësorë.

Prandaj, krahas rekomandimeve të fushës legjislative, KRPP rekomandon që:

- të fuqizohet edhe më tutje aktiviteti i monitorimit të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AK-së dhe zbatimit të drejtë të legjislacionit në fuqi, duke u bazuar në një metodologji të monitorimit e bazuar në rreziqe të cilat potencialisht kufizojnë ofertimin ose dështojnë aktivitetin e prokurimit dhe e bazuar në aplikim të masave ndëshkuese për secilin zyrtarë të prokurimit dhe AK që nuk zbaton drejtë dhe anashkalon legjislacionin në fuqi;
- të vazhdohet me trajnime të avancuara/shitesë për zyrtarët e prokurimit në aspektin e ndryshimeve kryesore ligjore të përfshira në Rregulloren e re të Prokurimit Publik.
- të nxjerren dhe publikohen interpretime për AK-se dhe OE të cilat duhet të adresojnë rastet më të shpeshta me paqartësi ligjore të evidentuara gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit dhe implementimit të kontratave;

- të mbahen trajnime, sesione informuese me takime të drejtëpërdrejta dhe me njoftime të publikuara për përdorues të sistemit të prokurimit elektronik mbi rëndësinë e konsultimit të manualeve udhëzuese, video materialve, etj në përdorim të sistemit të prokurimit elektronik, si në zhvillimin e procedurave të prokurimit ashtu edhe në pjesën e menaxhimit të kontratave;

Sfidat: Krahas rekomandimeve të paraqitura në këtë raport, edhe këtë vit KRPP është përballur me sfida të ndryshme, e më së shumti në mungesë të kapaciteteve profesionale të brendshme për të përballuar dinamikën e ndryshimeve dhe reformave të kërkuara në fushën e prokurimit publik.

Me aplikimin e prokurimit elektronik dhe mandatin e KRPP-së në fushën e prokurimit elektronik, mungesa e kapaciteteve profesionale, jo vetëm në fushën e prokurimit publik por edhe në fushën e TI-së do të jetë sfida më e madhe në realizimin e detyrave, obligimeve dhe përgjegjësisë në raport me objektivat aktivitetet dhe detyrimeve për vitet vijuese.

Duhet theksuar që sfida e mungesës së kapaciteteve bëhet edhe më e dukshme duke ditur që viteve të fundit dhe në vazhdimësi KRPP ballafaqohet me ikje të nëpunësve (ekspertëve të prokurimit) me përvojë (duke u angazhuar në projekte/institucione për një pagë më të mirë) dhe ekspertëve të TI-së të cilët gjithashtu pas përvojës së fituar në KRPP janë më atraktiv për sektorin privat ose institucionet ku paguhen më mirë.

Dihet që sistemi i prokurimit elektronik, është sistem i rëndësisë dhe ndjeshmërisë së veçantë, kërkon administrim për një disponueshmëri dhe siguri të lartë, është një nga sistemet e teknologjisë informative me përdorim dhe shtrirje më të gjerë në nivel qeveritar dhe është një sistem që në vazhdimësi kërkon avancime teknologjike për t'u përshtatur me aplikim të metodave të reja në prokurim dhe nevojat për integrim/ndërveprim me sisteme të tjera qeveritare – kërkesa të cilat num mund të realizohen pa kapacitete të mjaftueshme të ekspertëve të TI-së.

Prandaj, duke ditur dinamikën e proceseve dhe zhvillimeve në sektorin e prokurimit publik që pritet të ndodhin gjatë vitit 2023 (sidomos miratimi i Ligjit të ri të Prokurimit Publik dhe obligimet dhe përgjegjësitë që burojnë nga ky ligj për KRPP-në), mungesa e kapaciteteve/burimeve njerëzore do të jetë sfida kryesore për KRPP-në.

Në këtë mënyrë KRPP rekomandon që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës t'i përgjigjet pozitivisht kërkesave buxhetore të KRPP-së që kanë të bëjnë me aprovimin e Ligjit të ri të Prokurimit Publik dhe aktivitetet që sigurojnë qëndrueshmëri, disponueshmëri dhe operim të pandërprerë të sistemit të prokurimit elektronik, sidomos në kërkesat që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore (ekspertëve të TI-së dhe ekspertëve të prokurimit) brenda KRPP-së në mënyrë që KRPP çdo herë dhe në çdo situatë të jetë e gatshme në përmbushjen mandatit si ofrues i shërbimeve për prokurim elektronik.

7. RAPORTI VJETOR FINANCIAR

DEKLARATË E PASQYRAVE FINANCIARE

Për: **Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere**

Nga: **Osman Vishaj, Zyrtar Kryesor Administrativ (ZKA)**

Albenita Berisha, Zyrtar Kryesor Financiar (ZKF)

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2022.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Data: 01/03/2023

Datë: 01/03/2023

(Nënshkrimi i ZKA)

(Nënshkrimi i ZKF)

Neni 13

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për KRPP-në				
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022				
	Shënim	2022	2021	2020
		Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
		BKK '000	BKK '000	BKK '000
BURIMET E FONDEVE -PRANIMET				
Granti qeveritar		507.00	589.00	691.00
Të hyrat vetanake				
Të hyrat e dedikuara				
Të hyrat nga AKP				
Grantet e përcaktuara të donatorëve				
Klauzola e investimeve				
Fondi zhvillimor në mirëbesim				
Pranimet tjera				
Gjithsej		507.00	589.00	691.00
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT				
Operacionet				
Paga dhe rroga	2	316.00	304.00	305.00
Mallra dhe shërbime	3	189.00	230.00	240.00
Shpenzime komunale	4	2.00	2.00	2.00
		507.00	536.00	547.00
Transferet				
Transfere dhe subvencione	5			
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	-	53.00	144.00
Pagesa tjera	7			
Gjithsej		507.00	589.00	691.00

Shënim: Nga pasqyra e mësipërme vërehet që totali i pranimeve dhe pagesave në para të gatshme është nga Granti Qeveritar në vlerë prej 506,539€

Neni 14

Raporti i ekzekutimit te buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për KRPP-në
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022

		2022				2021	2020
		Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Varianca	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D=B-A	E	F
		€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Shënime							
HYRJA E PARASË SË GATSHME							
Të hyrat tatimore	8				#DIV/0!		
Të hyrat jo tatimore	9				#DIV/0!		
Të hyrat e dedikuara	10				#DIV/0!		
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11				#DIV/0!		
Tjera	12				#DIV/0!		
Gjithsej Pranimet		-	-	-	#DIV/0!	-	-
DALJA E PARASË SË GATSHME					#DIV/0!		
Paga dhe rroga	2	316	360	360	87.78%	304	305
Mallra dhe shërbime	3	189	279	279	67.74%	230	240
Shpenzime komunale	4	2	5	5	40.00%	2	2
Transfere dhe subvencione	5				#DIV/0!		
Shpenzime kapitale	6	-	-	70	#DIV/0!	53	144
Tjerat	7				#DIV/0!		
Gjithsej pagesat		507	644	714	#DIV/0!	589	691

Neni 15

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

Shënimi 1

1. Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2022 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

1.1 Informata për organizatën buxhetore (aktivitetet, legjislacioni, etj)

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës behën përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) është themeluar në bazë të Pjesës VI të Ligjit Nr. 04/L-042 për prokurim Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Sipas nenit 86 të këtij ligji, KRPP-ja është agjenci e pavarur, rregullative dhe sipas nenit 87 të këtij ligji është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë dhe i ushtron funksionet që jepen nga ky ligj.

Misioni i KRPP-së është zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e përgjithshme e sistemit të prokurimit publik në Kosovë, si dhe zhvillimi, funksionimi dhe mbikqyrja e sistemit elektronik të prokurimit publik në Kosovë (E-Prokurimi).

Si rrjedhojë, misioni i KRPP-së është të nxis respektimin e parimeve themelore të prokurimit lidhur me transparencën, llogaridhënien, konkurrencën e ndershme, trajtim të barabartë dhe vlerën për para duke përmirësuar kapacitetin e sistemit të prokurimit përmes:

- Avancimit të sistemit të monitorimit për zbatimin e kornizës ligjore të prokurimit publik,
- Zhvillimi i burimeve njerëzore, trajnimi dhe arsimi,
- Avancimi i procedurave të menaxhimit të prokurimit të prokurimit publik,
- Rrjedhë më të mirë të komunikimit në mes të të gjithë akterëve të prokurimit publik,

- Prezanitimin e objektivave socio-ekonomike dhe mjedisore, në kuadër të politikave të gjelbra dhe të përgjithshme shoqërore të prokurimit publik, shfrytëzimin e metodave të reja bashkëkohore në zbatimin e ligjit të prokurimit publik si: prokurimit elektronik dhe prokurimi i centralizuar, si dhe
- Ngritjen e vetëdijes së zyrtarëve për funksionimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë.

KRPP-ja ka si qëllim kryesor garantimin e mirëfunksionimit të sistemit të prokurimit publik në Kosovë, duke u fokusuar në aktivitetet dhe veprimtarinë e saj si në vijim:

- Përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit ligjor,
- Monitorimin e vazhdueshëm të procedurave të prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktuese,
- Përmirësimin e vazhdueshëm të Sistemit Elektronik të Prokurimit,
- Ngritja e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit në Autoriteteve Kontraktore,
- Dhënia e asistencës së vazhdueshme për Autoritetet Kontraktore,

Rritja e efikasitetit të prokurimit publik.

1.2 Pagesat nga palët e treta

Në zbatim të SNKSP 2017 pagesat nga palët e treta, KRPP konfirmon që gjatë periudhës fiskale 2022 nuk ka psaur pagesa nga palët e treta.

1.3 Shumat raportuese

Shumat raportuese nga neni:

13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€),

16 deri te neni 24 shumat janë shuma e plotë Euro (€).

1.4 Valuta raportuese

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€),

1.5 Data e autorizimit

Autorizohen me datën e nënshkrimit të deklaratës për Pasqyrat Financiare nga Zyrtari Kryesore Administrativë dhe Zv. Zyrtarja Kryesore Financiare.

Neni 14.6

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Ndryshimet e autorizuar nga LMFP

Kategoria e ndarjes	Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit) € '000	Ndryshimi I € '000	Ndryshimi II € '000	Ndryshimi III € '000	Ndryshimi IV € '000	Të hyrat vetanake € '000	Grantet e percaktuara te donetoreve € '000	Burime tjera te financimit € '000	Buxheti përfundimtar SIMFK € '000
Hyrjet									
Të hyrat tatimore									-
Të hyrat jo tatimore									-
Të hyrat e dedikuara									-
Grantet e percaktuara të donatorëve									-
Huamarrjet									-
Tjera									-
Gjithsej	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Daljet									
Paga dhe rroga	360								360
Mallra dhe shërbime	279								279
Shpenzime komunale	5								5
Transfere dhe subvencione									-
Shpenzime kapitale	70		(70)						-
Kthimi i huamarrjeve									-
Tjerat									-
Gjithsej	714	0	(70)	0		0	0	0	644

Nga tabela e mësipërme më saktësisht neni 14.6 shihet harmonizim i ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit për vitin 2022. Gjatë periudhës raportuese me vendim të qeverisë kemi deklaruar kursime në kategorinë e investimeve kapitale.

Shënimi 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën **D (neni 14)**, domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë se gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkojnë ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës së ndryshimit.

Shënimi 2 Paga dhe rroga

Përshkrimi	2022									Krahasim %	2021	2020
	Gjithsej Pagesat	GQ	THV	THD	TH-AKP	GPD	K I	FZHM	Buxheti Final		€ '000	€ '000
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		€ '000	€ '000
Pagat neto përmes listës së pagave	267	267							360		257	258
Pagesa per sindikatë	-											
Pagesa neto për punë jashtë orarit	-											
Puntëtorët me kontratë (jo në listen e pagave)	-											
Tatimi ndaluar në të ardhura personale	19	19									18	18
Kontributi pensional-punetori	15	15									15	15
Kontributi pensional-punëdhënësi	15	15									15	15
Paga dhe rroga	316	316	-	-	-	-	-	-	360	88%	305	306

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë: Buxheti final i KRPP-së për paga në vitin 2022 është 360,146€ i cili është shpenzuar 316,066€ apo 88% e buxhetit final.

Shënimi 3 Mallra dhe shërbime

Përshkrimi	2022									Krahasim %
	Gjithsej Pagesat	GQ	THV	THD	TH-AKP	GPD	K I	FZHM	Buxheti Final	
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	61.95	61.95								
Meditjet për udhëtime zyrtre brenda vendit	64.00	64								
Akomodimi udhëtime zyrtre brenda vendit	-									
Shpenzime tjera për udhëtime zyrtre brenda vendit	-									
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	974.59	974.59								
Meditjet për udhëtime zyrtre jashtë vendit	-									
Akomodimi udhëtime zyrtre jashtë vendit	286.25	286.25								
Shpenzime tjera udhëtime zyrtre jashtë vendit	312.92	312.92								
Shpenzimet per internet	-									
Shpenzimet e telefonisë mobile	10,259.02	10259								
Shpenzimet postare	-									
Shpenzimet për përdorimin e kabllit optik	-									
Shërbimet e arsimit trajnimit	-									
Shërbimet e përfaqësimit avokatë dhe ekspertë	-									
Shërbime të ndryshme shëndetsore	-									
Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	40,397.60	40397.6								
Sherbime shtypje-jo marketing	316.02	316.02								
Sherbime kontraktuese tjera	2,718.58	2718.58								
Sherbime teknike	-									
Shpenzimet per anetaresim	-									
Sherbimet e varrimit	-									
Mobilje (me pak se 1000 euro)	2,430.00	2430								
Telefona (me pak se 1000 euro)	-									
Kompjuterë me pak se 1000 euro	2,351.70	2,352								
Harduer për teknologji informative (më pak se 1000 euro)	-									
Furnizim per zyre	1,550.74	1,551								
Sigurimi I automjeteve	370.57	371								
Taksa komunale per regjistrim te automjeteve	170.00	170								

Nga shënimet e pasqyruara në tabelë shihet që buxheti final i KRPP-së për vitin 2022 nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve është në vlerë prej **279,253€** i cili është shpenzuar në vlerë prej **189,116€** apo **68%**.

Shënimi 4 Shpenzime komunale

Përshkrimi	2022								Buxheti Final € '000	Krahasim %	2021 € '000	2020 € '000
	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	TH-AKP € '000	GPD € '000	K I € '000	FZHM € '000				
Rryma	-											
Uji	-											
Mbeturinat	-											
Ngrohja Qendrore	-											
Shpenzimet telefonike	2	2							5		2	3
Pagesa-vendimet gjyqësore	-											
Shpenzime komunale	2	2	-	-	-	-	-	-	5	40%	2	3

Buxheti final për shpenzime komunale është 5,000€, ndërsa realizimi është në vlerë prej 1,357€ apo 40%.

Shënimi 5 Subvencione dhe transfere

Përshkrimi	2022									Krahasim	2021	2020
	Gjithsej Pagesat € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	TH-AKP € '000	GPD € '000	K I € '000	FZHM € '000	Buxheti Final € '000		€ '000	€ '000
Subvencione për entitetet publike	-											
Subvencionet për entitetet publike (tea.bib)	-											
Subvencione për entitetet jopublike	-											
Transfere për qeveri tjera	-											
Pagesat për përfituesit individual	-											
Pensionet bazë	-											
Pensionet baze kotributdhenese	-											
Pensionet për personat me nevoja të veçanta	-											
Pensionet e ndihmës sociale	-											
Pensionet per te burgosurit	-											
Pensionet për veteranët e luftës	-											
Pensionet per te verbërit	-											
Pensionet e TMK-së	-											
Pensionet e FSK-së	-											
Pagesat për invalidët e luftës	-											
Pagesat për familjet e të rënëve në luftë	-											
Pensionet e përkohshme të Trepçës	-											
Pushimi i lehonave	-											
Pagesa për vendime gjyqesore	-											
Pagesat per sektorin e blegtorise	-											
Pagesat per kulturat	-											
Ristrukturimi i potencialit fizik	-											
Menaxhimi i burimeve të ujitjes për bujqesi	-											
Diversifikimi i fermave	-											
Subvencione dhe transfere	-	-	-	-	-	-	-	-	-	#DIV/0!	-	-

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Gjatë periudhës raportuese KRPP nuk ka psaur subvencione dhe transfere.

Shënimi 6 Shpenzime kapitale

Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	%	€ '000	€ '000
Ndërtesat e banimit	-											
Ndërtesat administrat. afariste	-											
Objektet arsimore	-											
Objektet shëndetësore	-											
Objektet kulturore	-											
Objektet sportive	-											
Objektet memoriale	-											
Rrethoja	-											
Depot	-											
Garazha	-											
Fushat sportive	-											
Ndërtimi i auto rrugëve	-											
Ndërtimi i rrugëve regjionale	-											
Ndërtimi i rrugëve lokale	-											
Trotuaret	-											
Kanalizimi	-											
Ujësjiellësi	-											
Mirmbajtja investive	-											
Furn.me rrym,gjenrimitransmis	-											
Paisje të teknologjis inform	-										53	144
Shto kode sipas nevojës	-											
Shpenzime Kapitale	-	-	-	-	-	-	-	-	-	#DIV/0!	53	144

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Pavarsisht planifikimit, gjatë periudhës raportuese KRPP nuk ka pasur shpenzime nga kategoria e investimeve kapitale.

Shënimi 7 Tjera

Natyra e pagesës	2022	2021	2020
	€ '000	€ '000	€ '000
Depozita 1			
Depozita 2			
Depozita 3			
Depozitat tjera			
Gjithsej	0	0	0

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Shënimi 8 Te hyrat tatimore

Përshkrimi	Shënim e	2022	2021	2020	% e totalit 2022	% e ndryshimit nga 2021
		€ '000	€ '000	€ '000		
Të hyrat tatimore 1					%	%
Të hyrat tatimore 2					%	%
Të hyrat tatimore 3					%	%
Të hyrat tatimore 4					%	%
Gjithsej		0	0	0	0%	%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Për periudhën raportuese KRPP nuk mbledhë të hyra tatimore.

Shënimi 9 Të hyrat jo tatimore

Përshkrimi	Shënim e	2022	2021	2020	% e totalit 2022	% e ndryshimit nga 2021
		€ '000	€ '000	€ '000		
Të hyrat nga taksat 1					%	%
Të hyrat nga taksat 2					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2					%	%
Të hyrat nga licencat 1					%	%
Të hyrat nga licencat 2					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria					%	%
Pranimet tjera					%	%
Gjithsej		0	0	0	0%	%

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Për periudhën raportuese KRPP nuk mbledhë të hyra jo tatimore.

Shënimi 10 Të hyrat e dedikuara

Përshkrimi	Shënime	2022	2021	2020	% e totalit 2022	% e ndryshimit nga 2021
		€ '000	€ '000	€ '000		
Lloji i të hyrës 1						
Lloji i të hyrës 2					%	%
Lloji i të hyrës 3					%	%
Lloji i të hyrës 4					%	%
Gjithsej		0	0	0	0%	%

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Për periudhën raportuese KRPP nuk mbledhë të hyra të dedikuara.

Shënimi 11 Grantet e përcaktuara të donatorëve

Përshkrimi			2022	2021	2020
			€ '000	€ '000	€ '000
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	-	-	-
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	-	-	-
Emri i donatorit	Numri i projektit	Emri i projektit	-	-	-
Gjithsej			0	0	0

Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:

Për periudhën raportuese KRPP nuk ka pasur grante të donatorëve

Shënimi 12 Tjera

Natyra e pranimit	2022 € '000	2021 € '000	2020 € '000
Depozitat 1			
Depozitat 2			
Depozitat 3			
Depozitat tjera			
↓			
Gjithsej	0	0	0

Shpalos në detaje shënimet në tabelë:

Shënimi 13 Pagesa nga palët e treta

<u>Kategoria ekonomike</u>	<u>2022</u> <u>€ '000</u>	<u>2021</u> <u>€ '000</u>	<u>2020</u> <u>€ '000</u>
Paga dhe rroga			
Mallra dhe shërbime			
Shpenzime komunale			
Transfere dhe subvencione			
Shpenzime kapitale			
Gjithsej pagesat nga palët e treta	<u>0</u>	<u>0</u>	<u>0</u>

Shpalos tabelën në detaje si në tabelën në vijim aneks 1:

Për periudhën raportuese KRPP nuk ka pasur pagesa nga palët e treta.

Neni 16 Raport për të arkëtueshmet

Të arkëtueshmet (zbatohet për organizatat që mbledhin të hyra)

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2022	2021	2020
Gjithsej		0	0	0

Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 1: KRPP nuk mbledhë të hyra.

Data e lëshimit te fatures	Numri i faturës	Kodi ekonomik	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	2022
Gjithsej						0

Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara

		2022		2021		2020	
Kategoria Ekonomike	Kategoria ekonomike	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë
11	Paga dhe roga						
13	Mallra dhe shërbime	2,846		6,950		19,330.51	
14	Shpenzime komunale						
20	Transfere dhe subvencione						
30	Shpenzime kapitale						
Gjithsej		2846	0	6950	0	19330.51	0

Shpalos ne PF tabelën në detaje dhe sipas formatit si Aneks 2 Obligimet e papaguara me buxhetin e vitit 2022 në vlerë prej 2846€ mbeten në ngarkim të buxhetit të vitit fiskal 2023. Arsyeja e mos pagesës është pasiqë faturat janë pranuar në zyren për buxhet dhe financa pas mbylljes së afatit të zotimeve.

RAPORTI VJETOR 2022

Data e pranimit te fatures	Numri i faturës	Kodi ekonomik	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	Arsyeja e mospagesës	2022
1/12/2022	355/2022	14010		Ajani Adami Shpk	Mirembajtja e automjeteve (autolarje) Sherbimet e perkthimit dhe lektorimit	Faturat janë pranuar pas mbylljes së afatit të zotimve	28
2/12/2022	788/22	13460		Nsh prestige	Shpenzimet e reprezentacionit		96.27
14/12/2022	330336	14310		Shqiponja BFB	Shpenzimet e reprezentacionit		456.2
27/12/2022	994	14310		Hotel Sirius	Shpenzimet e reprezentacionit		913.22
27/12/2022	22-shv61-009-6690	14310		Extra Fish	Shpenzimet e reprezentacionit		1352.8
Gjithsej							2,846.49

Neni 18 Detyrimet kontingjente

Natyra e detyrimeve kontingjente	Arsyeja për detyrime	Vlera e vlerësuar ose e saktë		
		2022	2021	2020
Aktgjykimi Ac.nr.4218/18	Demolim I objektit	17,279	17,279	17,279
Gjithsej		17279	17279	17279

Shpalos në detaje shënimet në tabelë: Gjykata Themelore në Prishtinë ka aprovuar kërkesën e paditësit në emër të kompensimit të dëmit material që është shkaktuar në objekt pas skadimit të kontratës për qiramarrje të datës 12/09/2008.

Neni 19 Raport për pasurinë jo financiare

Neni 19.3.1 Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2022	2021	2020
Ndërtesat			
Toka			
Pajisjet	376,773.76	162,303.79	135,697.21
Infrastruktura			
Makineria			
Automjetet			
Tjera			
Gjithsej	376773.76	162303.79	135697.21

Neni 19.3.2 Pasuritë jo kapitale (me vlerë nën 1,000 Euro)

Klasifikimi i pasurive	2022	2021	2020
Pajisjet dhe mobiljet	50,590.95	107,948.83	104,928.86
Gjithsej	50590.95	107948.83	104928.86

Shpalos ne PF tabelën në detaje në vijim si Aneks 3: Në anekset e bashkangjitura këtij raporti i gjeni detajet mbi raportin për pasurinë financiare me vlere mbi 1000 euro.

Neni 19.3.3 Stoqet

Klasifikimi i pasurive	2022	2021	2020
Stoqet	2,289.63	2,605.75	2,772.82
Gjithsej	2289.63	2605.75	2772.82

Neni 20 Raport për avancet e pa arsyetuara

Data e lëshimit	ID e furnitorit të Zyrtarit	Nr i CPO	Qëllimi	2022
Gjithsej				0

Shpalos me poshtë në detaje shënimet nga tabela: Gjatë periudhës raportuese KRPP nuk ka avanse të hapura ose të bartura nga viti paraprak.

- shpalosje e avanseve të hapura ose të bartura nga viti paraprak, së bashku me arsyen e mos-mbylljes
- shpalos veprimet e ndërmarra për mbylljen e tyre, përfshirë ndalesën në page apo iniciimin e procedurave ligjore për kthimin e tyre

Neni 21 Raport për të hyrat vetanake të pashpenzuara

Përshkrimi	2022	2021	2020
Të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar			
Të hyrat vetanake të pranuar në këtë vit			
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	-	-	-
Shuma e shpenzuar në vitin aktual			
Shuma e mbetur për bartje	-	-	-

Neni 22 Raport për bilancet e pashpenzuara të Fondit Zhvillimor në Mirëbesim

Përshkrimi	2022	2021	2020
Të hyrat nga fondi zhvillimor në mirëbesim nga viti i kaluar			
Të hyrat vetanake të pranuar në këtë vit			
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	-	-	-
Shuma e shpenzuar në vitin aktual			
Shuma e mbetur për bartje	-	-	-

Neni 23 Raport për të hyrat e dedikuara

Përshkrimi	 2022	 2021	2020
Të hyrat e dedikuara nga viti i kaluar			
Të hyrat e dedikuara të pranuar në këtë vit			
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	-	-	-
Shuma e shpenzuar në vitin aktual			
Shuma e mbetur për bartje	-	-	-

Neni 24 Raport për fondet e donatorëve të pashpenzuara

Përshkrimi	 2022	 2021	2020
Grantet e përcaktuara të donatorëve të bartura nga viti i kaluar			
Grantet e përcaktuara të donatorëve të pranuar në këtë vit			
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	-	-	-
Shuma e shpenzuar në vitin aktual			
Shuma e mbetur për bartje	-	-	-

Nenit 22, 23 dhe 24 gjatë periudhës raportuese për KRPP-në nuk aplikohet

Neni 25 Raport për numrin e punëtorëve sipas listës së pagave

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2022		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2021		Nr aktual i punëtorëve në fund të	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti 1	42	35	0	36	0	36	0
Departamenti 2							
Departamenti 3							
Gjithsej							

Me ligjin e buxhetit për vitin 2022 KRPP ka të aprovuara 42 pozita prej të cilave tre (3) janë funksionar publik. Ndërsa gjatë periudhës raportuese numri i të punësuarve përfshirë këtu bordin dhe dy nënpunës të kabinetit është 35

Neni 26 Raport për numrin e të punësuarve jashtë listës së pagave

Departamenti	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2022		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2021		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2020	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti 1	0	0	0	0	0	0
Departamenti 2						
Departamenti 3						
Gjithsej						

Sqarim: Shpalos arsyen e angazhimit, kohëzgjatjen, qëllimin dhe listën e personave të angazhuar.

Neni 27 Raport për numrin e të punësuarve me kontrate për shërbime të veçanta

Departamenti	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2022		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2021		Nr aktual i punëtorëve në fund të	
	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Departamenti 1	2	0	2	0	2	0
Departamenti 2						
Departamenti 3						
Gjithsej						

Sqarim: Shpalos arsyen e angazhimit, kohëzgjatjen, qëllimin dhe listën e personave të angazhuar.

KRPP gjatë periudhës raportuese ka të punësuar 2 zyrtar me kontratë për shërbime të veçanta.

Përmes procedurave të prokurimit janë të angazhuar dy (2) Ekspert të IT-së me kohëzgjatje prej 36 muajve. Pasi që resurset e TI-së në KRPP nuk siguruan mjaftueshëm kapacitete për të menaxhuar dhe administruar sistemin e e-prokurimit gjë që ka qenë e nevojshme të angazhohen ekspert të kualifikuar me qëllim të administrimit dhe menaxhimit të sistemeve informative komplekse dhe të ndjeshme.

8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TE REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr	Rekomandimi	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vleresimi i rrezikut
1	Kryetari duhet të sigurojë se vlera e pasurisë në PFV prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto si dhe të ngarkohen zyrtarët me pasurinë në posedim.	Vlera e prezentuar në libër bazuar në raportin e gjeneruar nga zyrtari i e-pasurisë për pasuritë jo kapitale nën 1000€ është e prezentuar drejtë, si dhe të gjithë zyrtarët janë ngarkuar me pasurinë në posedim në sistemin e-pasuria.		Rekomandim I zbatuar.	

Detajet sqaruese:

- Rekomandimi i auditorit për pasurinë kapitale me vlerë nën 1000 euro i bartur nga viti paraprak konsiderohet i zbatuar.
- Gjatë vitit 2022 KRPP ka pasur auditim të brendshëm për vitet paraprake dhe nga rekomandimet e dhëna konsiderohen të zbatuara.

9. KONTRATAT E NËNSHKRUARA – STATISTIKAT

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) për çdo vit kalendarik duhet të përgatisë dhe dorëzojë në Qeveri dhe Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë për atë vit kalendarik. Gjatë vitit 2022 në Kosovë janë evidentuar 162 autoritete kontraktuese që kanë kryer prokurime, ndërsa për 16 autoritete kontraktuese prokurimet i ka kryer Agjencioni Qendror i Prokurimit.

Përmes raporteve vjetore mbi kontratat e nënshkruara publike, të cilat autoritetet kontraktuese gjatë janarit të vitit 2023, i kanë dërguar në mënyrë elektronike pranë departamentit të monitorimit, i cili i ka pranuar dhe ka kontrolluar këto raporte të dërguara nga autoritetet kontraktuese.

Bazuar në raportet e dërguara nga autoritetet kontraktuese, shihet se gjatë vitit 2022 në tërë Kosovën janë nënshkruar 10290 kontrata publike të udhëhequra sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, duke i përfshirë të gjitha llojet e vlerave të kontratave.

Në vazhdim të raportit do t'i paraqesim prokurimet publike në Kosovë sipas kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022. Duke pasur për bazë raportet e viteve paraprake, të përgatitura nga KRPP-ja sipas kërkesave të LPP-së, raporti në vijim paraqet aktivitetet e prokurimit, pra të gjitha kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, duke bërë një analizë të kontratave të nënshkruara sipas burimeve të financimit, llojit të autoriteteve kontraktuese, sipas llojit të kontratave, vlerës së kontratave, procedurave të përdorura, aneks-kontratave, operatorëve ekonomikë të shpërblyer me kontratë, afateve kohore të publikimit dhe kriterëve të shpërblimit me kontratë.

Pra, raporti në vazhdim i pasqyron të gjitha aktivitetet e prokurimit publik të zhvilluara gjatë vitit 2022 në Kosovë, duke i analizuar dhe duke i krahasuar me vitet paraprake, me ç'rast do ta shohim trendin e zhvillimit të Prokurimit Publik në Kosovë.

Ky raport do jetë i dobishëm edhe për të gjitha institucionet financiare monetare ndërkombëtare që operojnë në Kosovë, sepse do të kenë në dispozicion një raport në të cilin përfshihen aktivitetet e prokurimit publik në Kosovë sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktivitetëve të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit.


NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA GJATË VITIT 2022

NUMRI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA				
Autoritetet kontraktuese:	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022 ³
Qeveritare	9216	8039	7175	7714
Kompani publike	3225	2888	2712	2576
Gjithësej:	12441	10927	9887	10290

Tabela 9.1

